



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 175

Tiranë – E Martë, 18 Nëntor 2014

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 141/2014 datë 23.10.2014	Për disa shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	8677
Ligj nr. 143/2014 datë 23.10.2014	Për një ndryshim në ligjin nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, të ndryshuar.....	8677
Ligj nr. 144/2014 datë 23.10.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për linjën e kredisë për Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave.....	8678
Ligj nr. 145/2014 datë 23.10.2014	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin për Sistemin Europian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit (EUCARIS).....	8689
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 22.10.2014	Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”	8695



LIGJ
Nr. 141/2014

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 10383,
DATË 24.2.2011, “PËR SIGURIMIN E
DETYRUESHËM TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 5, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë së Brendshme.”.

Neni 2

Pas nenit 29 shtohet neni 29/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 29/1

**Kontrata me dhënësit e shërbimit
shëndetësor jashtë vendit**

1. Kur nuk mund të plotësohen nevojat për dhënien e shërbimit shëndetësor nga dhënës privatë dhe publikë brenda vendit, Fondi ka të drejtë të lidhë kontrata me dhënës të shërbimit shëndetësor jashtë vendit për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore.

2. Përzgjedhja e dhënësve të shërbimeve shëndetësore jashtë vendit, që do të kontraktojnë me Fondin, bëhet në bazë të procedurave dhe të rregullave të përcaktuara nga Këshilli Administrativ i Fondit.

3. Procedurat për paraqitjen e kërkesës për pagesë, të verifikimit të tyre dhe të pagesës së dhënësve të shërbimeve shëndetësore jashtë vendit, përcaktohen në rregulloret e miratuara nga Këshilli Administrativ.

4. Regjistrimi i dhënësve të shërbimit shëndetësor jashtë vendit, në regjistrin e dhënësve të përzgjedhur të shërbimeve shëndetësore bëhet sipas të njëjtave rregulla të parashikuara në nenin 29, të këtij ligji.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.10.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8780, datë 12.11.2014
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 143/2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.
9876, DATË 14.2.2008, “PËR PRODHIMIN,
TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E
BIOKARBURANTEVE DHE TË
LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË
RINOVUESHME, PËR TRANSPORT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, të ndryshuar, neni 10, “Regjimi tatimor”, riformulohet si më poshtë:

“Neni 10

Regjimi tatimor

1. Biokarburantet që përdoren në sektorin e transportit, që prodhohen në Republikën e Shqipërisë nga njësitë për prodhimin e biokarburanteve, sipas përcaktimit të nenit 5, të këtij ligji, si dhe lëndët e para që përdoren për prodhimin e tyre u nënshtrohen një trajtimi të veçantë fiskal, që i bën ato të konkurrueshme në treg.



Në periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në vitin 2018, niveli i akcizës për këto produkte do të jetë zero.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të domosdoshëm, që duhet të plotësojnë subjektet, për të përfutur këto lehtësi, sikurse përcaktohet në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8781, datë 12.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**LIGJ
Nr. 144/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË GARANCISË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS EUROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)
PËR MARRËVESHJEN E HUAS
NDËRMJET AGJENCISË SHQIPTARE
TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE
BANKËS EUROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR
LINJËN E KREDISË PËR AGJENCINË
SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË
DEPOZITAVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për linjën e kredisë për

Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8782, datë 12.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

(Numri i operacionit 45446)

**MARRËVESHJE GARANCIE
PËR LINJËN E KREDISË PËR AGJENCINË
SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË
DEPOZITAVE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Marrëveshje Garancie e datës _____ 2014 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) (Marrëveshja e Garancisë).

PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë se Garantuesi dhe Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të Projektit;

duke marrë në konsideratë se në pajtim me një marrëveshje huaje të së njëjtës datë ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës (“Marrëveshja huas”, siç përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standarde, Banka ka rënë dakord të hapë një linjë kredie për Huamarrësin në shumën 100 milionë euro, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Huas, por vetëm me kushtin që Garantuesi të garantojë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas sipas parashikimit në këtë Marrëveshje; dhe

duke marrë në konsideratë se Garantuesi, për sa i takon lidhjes së Marrëveshjes së Huas ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, ka rënë dakord të garantojë këto detyrime të Huamarrësit.

rrjedhimisht, palët bien dakord si më poshtë:



Neni 1

Termet dhe Kushtet Standarde; përkufizime

Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës të datës 1 dhjetor 2012 përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtin efekt dhe fuqi sikur të ishin parashikuar këtu (këto dispozita quhen më poshtë "Termet dhe Kushtet Standarde").

Seksioni 1.02. Përkufizime

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën), përveç kur deklarohet ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përkufizuara në preambulë kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre këtu; termat e përkufizuara në Termet dhe Kushtet Standarde dhe Marrëveshjen e Huas kanë kuptimet e tyre përkatëse të dhëna atyre këtu dhe termi i mëposhtëm ka kuptimin e mëposhtëm:

"Përfaqësues i autorizuar i Garantuesit" është Ministri i Financave i Garantuesit.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë në një nen ose seksion të caktuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë në atë nen ose seksion të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Garancia dhe procedura

Seksioni 2.01. Garancia

Garantuesi garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si i detyruar kryesor dhe jo thjesht si dorëzanë, pagesën e duhur dhe në kohë të çdo shume sipas Marrëveshjes së Huas, qoftë në afatin e caktuar të maturimit, të përsheptuar apo ndryshe, dhe përmbushjen në kohë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, të gjitha siç janë përcaktuar në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 2.02. Procedura

a) Garantuesi konfirmon që ka njohuri për termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Huas.

b) Banka bie dakord që çdo kërkesë për pagesë për Garantuesin sipas kësaj Marrëveshjeje të bëhet me shkrim dhe kjo kërkesë për pagesë të specifikojë shumën e mbetur sipas Marrëveshjes së Huas dhe që duhet paguar nga Garantuesi, datën brenda së cilës shuma duhet të paguhet nga

Garantuesi, e cila do të jetë një datë jo më pak se tre ditë pune nga data e njoftimit të kërkesës.

Neni 3

Të ndryshme

Seksioni 3.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimet e seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standarde:

Për Garantuesin:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Ministria e Financave

Nr. 3, bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë

Shqipëri

Në vëmendje të: Ministri i Financave

Faks:+355 42228494

Për Bankën:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Njësia e Administrimit të Operacioneve

Faks:+44-20-7338-6100

Seksioni 3.02. Opinioni ligjor

Për qëllimet e seksionit 9.03(b) të Termave dhe Kushteve Standarde dhe në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Huas, opinioni ose opinionet e këshilltarëve jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë. Formulari i këtij opinion i bashkëlidhet Marrëveshjes.

Në dëshmi të kësaj, Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në katër kopje dhe është shpallur në Tiranë në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga:

Emri:

Titulli: Ministri i Financave



BANKA EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:
Emri:
Titulli:

SHTOJÇË
FORMULARI I OPINIONIT LIGJOR TË
GARANTUESIT

(Koka zyrtare e letrës së Ministrisë së Drejtësisë)

Banka Europiane për
Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
England

(Datë)

Zonja dhe zotërinj,

Lënda: Opinion ligjor mbi Marrëveshjen e Garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Marrëveshjen e Huas ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe Zhvillim, të dyja të datës (); (operacioni nr. 45446).

Më () 2013 Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave (Huamarrësi) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) lidhën një marrëveshje huaje (Marrëveshja e Huas) dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Shteti) dhe Banka lidhën një marrëveshje garancie nëpërmjet së cilës Shteti garanton detyrimet e Huamarrësit në favor të Bankës (Garancia).

Në këtë Opinion, fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen e Huas kanë të njëjtat kuptime.

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, unë kam këqyrur kopjen e nënshkruar të secilës prej Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë dhe të gjithë dokumentacionin tjetër, kam shqyrtuar Kushtetutën e Shqipërisë, së bashku me ligjet, rregulloret, dokumentet dhe të tjera dhe kam kryer hetime të tjera që i çmoj të nevojshme dhe të përshtatshme për qëllimet e këtij Opinioni. Bazuar në sa më sipër, unë jam i mendimit dhe deklaroj përkatësisht që:

a) Nëpërmjet (vendosni referencën tek autorizimi i Qeverisë (ose të një personi apo organi tjetër) të dhënë për përfaqësuesin e Huamarrësit që të negociojë dhe nënshkruajë Garancinë në emër të Republikës së Shqipërisë), Presidenca (ose një person apo organ tjetër të autorizuar) autorizon () Ministrin e (), të lidhë dhe të nënshkruajë Garancinë në emër të Shtetit. Autorizimi i dhënë () për të ndërmarrë këto veprime në emër të Shtetit, vazhdon të mbetet në fuqi të plotë në momentin e nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve.

b) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (ose një person apo organ tjetër i autorizuar), pas shqyrtimit të projekteve të negociuara të Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë, vendosi më (vendosni datën e aprovimit) të aprovojë këto projekte të Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë.

c) Në pajtim me dispozitat e nenit 121 të Kushtetutës së Shtetit, negociimet dhe ratifikimet e traktateve i nënshtrohen vullnetit të Kuvendit Popullor të Shtetit.

d) Në pajtim me dispozitat e nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006 "Mbi huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë për huat shtetërore në Republikën e Shqipërisë", dhe neneve 117 dhe 121 të Kushtetutës së Shtetit, negociimi, nënshkrimi, shpallja dhe zbatimi i marrëveshjes së huas dhe lidhja e garancisë është dhënë pëlqimi nga Parlamenti i Shqipërisë në pajtim me (citoni ligjin e miratuar nga Parlamenti që ka dhënë pëlqimin e ratifikimit të Marrëveshjes së Huas).

e) Në pajtim me dispozitat e nenit () të Kushtetutës së Huamarrësit, Marrëveshja e Huas dhe Marrëveshja e Garancisë u ratifikuan nga Presidenca më (vendosni datën), e provuar nga (vendosni titullin e instrumentit të ratifikimit).

f) Në pajtim me dispozitat e (vendosni ligjin përkatës), kërkesa në lidhje me publikimin e njoftimit të nënshkrimit, shpalljes, ratifikimit ose përmbushjes, apo në një aspekt tjetër, të Marrëveshjes së Huas dhe Garancisë, është përmbushur dhe është e pranueshme.

g) Në pajtim me dispozitat e (vendosni ligjin përkatës), kërkesat në lidhje me nënshkrimin, shpalljen dhe realizimin e Garancisë janë përmbushur dhe janë të pranueshme.



h) Të gjitha veprimet, kushtet dhe autorizimet që duhet të nënshkruhen, përmbushen dhe realizohen me qëllim që t'i mundësohet Shqipërisë, si Garantues, dhe Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, si Huamarrës të lidhë, të ushtrojë të drejtat e saj dhe të përmbushë detyrimet e parashikuara në Marrëveshjen e Garancisë dhe Huas, përkatësisht janë përmbushur dhe realizuar në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Shqipërisë.

i) Detyrimet e Shtetit si Garantues dhe Agjencisë Shqiptare të Depozitave, si Huamarrës, siç janë parashikuar në Marrëveshjen e Garancisë dhe Huas, përkatësisht përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Garantuesit dhe Huamarrësit dhe janë të ekzekutueshme në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

j) Detyrimet e shtetit të parashikuara në Garanci përmbajnë detyrime ndërkombëtare të Shtetit dhe janë aprovuar në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Shtetit në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

Së fundi, jeni të lutur të vini re që Shteti ka miratuar një ligj që i jep Bankës privilegje, imunitete dhe përjashtime pasi Shqipëria është anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Me respekt
Ministri i Drejtësisë
Republika e Shqipërisë

(Numri i operacionit 45446)

MARRËVESHJE HUAJE

LINJA E KREDISË PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE NDËRMJET AGJENCISË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

2014

Marrëveshje e datës _____
2014 ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të depozitave (Huamarrësi) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë se Banka është themeluar për të dhënë financim për projekte të veçanta për të mbështetur kalimin drejt

ekonomive të hapura të orientuara nga tregu dhe për të nxitur iniciativat private dhe sipërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që u përkushtohen dhe zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

duke marrë në konsideratë se Huamarrësi synon të zbatojë projektin e përshkruar në grafikun 1, i cili është i caktuar të asistojë Huamarrësin për gjetjen e fondeve për të përmbushur detyrimet e veta ndaj depozitave të siguruara (siç përkufizohet termi në këtë Marrëveshje) në pajtim me ligjin për sigurimin e depozitave në Shqipëri;

duke marrë në konsideratë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

duke marrë në konsideratë se në pajtim me një marrëveshje garancie me të njëjtën datë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si Garantues dhe Bankës ("Marrëveshja e Garancisë", siç përkufizohet në Termat dhe Kushtet Standarde), Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

duke marrë në konsideratë se Banka ka rënë dakord në bazë të, ndërmjet të tjerash, sa më sipër t'i japë një hua Huamarrësit në shumën prej 100.000.000 euro, sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshjeje,

rrjedhimisht, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termat dhe Kushtet Standarde; përkufizime

Seksioni 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës të datës 1 dhjetor 2012 përfshihen dhe bëhen të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtin efekt dhe fuqi sikur të ishin parashikuar këtu, përveç kur nuk zbatohet Manuali i Disbursimit të BERZH-it (këto dispozita këtu quhen "Termat dhe Kushtet Standarde").

Seksioni 1.02. Përkufizime

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën dhe grafikët), përveç kur deklarohet ndryshe ose konteksti e kërkon



ndryshe, termat e përkufizuar në preambulë kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre këtu; termat e përkufizuara në Termat dhe Kushtet Standarde kanë kuptimet e tyre përkatëse të dhëna atyre këtu dhe termat e mposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

"Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit" është Drejtori i Përgjithshëm i Huamarrësit.

"Periodha e angazhimit" është periudha që fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe që përfundon në datën e fundit të disponibilitetit ose në një datë të mëvonshme që Banka mund të vendosë pas marrjes paraprakisht të një kërkesë me shkrim nga Huamarrësi (ku kjo kërkesë të kërkojë nëse ka Marrëveshje Garancie, të siglohët nga Garantuesi) dhe Banka njofton menjëherë Huamarrësin dhe Garantuesin për këtë datë të mëvonshme.

"Kërkesat e përcaktuara të performancës" janë kërkesat e performancës nga 1 deri në 8 dhe 10 (ose siç mund ta kërkojë konteksti, secila prej këtyre kërkesave të performancës) të kërkesave të performancës të muajit maj 2008 dhe që lidhen me politikën mjedisore dhe sociale të Bankës të muajit maj 2008.

"Vit fiskal" është viti fiskal i Huamarrësit që fillon më 1 janar të çdo viti.

"IFRS" janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të nxjerra ose miratuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit dhe që zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme.

"Depozita të siguruar" janë "depozitat e siguruar në një bankë ose degë të saj" dhe "depozitat e siguruar tek SCA-ja", siç përkufizohen këto terma në LDI.

"Rast sigurimi" është kuptimi i dhënë këtij termi tek LDI-ja.

"Politikë investimi" është një politikë investimi që është aprovuar herë pas here formalisht nga bordi mbikëqyrës dhe/ose drejtues i Huamarrësit.

"Ligji për bankat" është ligji nr. 9662 i datës 18.12.2006, i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, i cili mund të ndryshohet herë pas here.

"Ligji për SCA-të" është ligji nr. 8782, datë 03/05/2001, i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, i cili mund të ndryshohet herë pas here.

"LDI" është ligji për sigurimin e depozitave nr. (), datë () i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, i cili mund të ndryshohet herë pas here. {TË JEPET NGA DELEGACIONI PAS KALIMIT TË LIGJIT}.

"Institucion financiar anëtar" është një bankë ose një institucion tjetër financiar që është anëtar i skemës së sigurimit të depozitave të Huamarrësit dhe që ka kuptimin që i jepet termi "Anëtar subjekt i skemës së sigurimit të depozitave", tek LDI-ja.

"Statut" është statuti i Huamarrësit i cili mund të ndryshohet herë pas here.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë në një nen, seksion ose grafik të caktuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë në atë nen, seksion ose grafik të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Kushtet kryesore të Huas

Seksioni 2.01. Shuma dhe monedha

a) Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej 100.000.000 euro.

Seksioni 2.02. Terma të tjerë financiarë të Huas

a) Shuma minimale e tërheqjes është 8 milionë euro.

b) Shuma minimale e paradhënies është 8 milionë euro.

c) Shuma minimale e anulimit është 8 milionë euro.

d) Datat e pagesës së interesave janë 30 nëntor dhe 30 maj të çdo viti.

e) 1) Pas mbarimit të periudhës së angazhimit, çdo shumë e Huas e mbetur shlyhet nga Huamarrësi në këste të barabarta (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) gjysmëvjetore në çdo datë të pagesës së interesave të çdo viti, ku data e parë e shlyerjes së Huas është data e caktuar që përfaqëson datën e parë të pagesës së interesit që bie gjashtë muaj pas përvjetorit të pestë të kësaj Marrëveshjeje dhe data e fundit e shlyerjes së Huas është një datë e caktuar që bie në datën e parë të pagesës së interesit pas përvjetorit të dhjetë të kësaj Marrëveshjeje.



2) Pavarësisht nga sa më sipër, në rastin kur (i) Huamarrësi nuk e tërheq të gjithë shumën e Huas para datës së shlyerjes të Huas së specifikuar në Seksionin 2.02(e), dhe (ii) Banka e shtyn datën e fundit të disponibilitetit të specifikuar në seksionin 2.02(f) më poshtë në një datë që bie pas kësaj date të parë të shlyerjes së Huas, shuma e çdo tërheqjeje të bërë në ose pas datës së parë të shlyerjes së Huas alokohet për shlyerje në shuma të barabarta në disa data të shlyerjes së Huas që bien pas datës së kësaj tërheqjeje (ku Banka përshtat shumat e alokuara për të patur shifra të plota në çdo rast). Banka, herë pas here, e njofton Huamarrësin për këto alokime.

f) Data e fundit e disponibilitetit është data që bie në një datë të caktuar që përfaqëson përvjetorin e pestë të kësaj Marrëveshjeje, ose një datë tjetër të mëvonshme që Banka mund të vendosë, sipas diskrecionit të saj, pas marrjes së një kërkesë paraprake me shkrim nga Huamarrësi (ku kjo kërkesë, nëse ka Marrëveshje Garancie, siglohet nga Garantuesi) dhe njofton Huamarrësin dhe Garantuesin.

g) Norma e tarifës së angazhimit është (i) 0.5% në vit

h) Norma e komisionit të paguar paraprakisht është 0.5% e shumës principale maksimale të plotë të Huas (100.000.000 euro).

i) Huaja i nënshtrohet normës së ndryshueshme të interesit.

Seksioni 2.03. Tërheqjet

a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet vetëm për qëllimet e caktuara në grafikun 1 dhe me ndodhjen e rastit të mëposhtëm:

i) "Rasti i sigurimit" siç përkufizohet në LDI.

b) Huamarrësi mund të kërkojë një disbursim, duke i paraqitur Bankës një kërkesë origjinale për një disbursim të tillë të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit ose një person i caktuar nga ky përfaqësues i autorizuar në formularin e grafikut 3 dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, të paktën 7 (shtatë) ditë pune para datës së propozuar për një disbursim të tillë. Një kërkesë e tillë, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, është e parevokueshme dhe detyruese për Huamarrësin. Disbursimi do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet dhe zbatohet për Projektin në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Ekzekutimi i projektit

Seksioni 3.01. Detyrime të tjera pohuese për projektin

Pa kufizuar përgjithësimin e seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii), dhe 5.02(c)(iii) të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësi zhvillon biznesin e tij në pajtim me kërkesën 2 të performancës së BERZH-it.

Seksioni 3.02. Shpeshësia e raportimit dhe kërkesat e paraqitjes

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi paraqet raporte periodike për projektin të përmendura në seksionin 4.04(a)(iv) të termave dhe kushteve standarde dy herë në vit, brenda 120 ditëve pas përfundimit të periudhës për të cilën raportohet, deri sa të përfundojë projekti. Këto raporte përfshijnë karakteristikat e mëposhtme specifike:

1) Informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

A) ndryshimet kryesore në përbërjen e personelit ose bordin e Huamarrësit;

B) çdo ndryshim në anëtarësinë e një institucioni financiar anëtar;

C) çështjet që mund të ndikojnë në koston ose zbatimin e projektit; dhe çdo zhvillim në lidhje me bashkësponsorizuesit e mundshëm të Projektit;

D) çdo zhvillim ose aktivitet që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të Huamarrësit ose të një institucioni financiar anëtar;

E) çdo zhvillim ose aktivitet që mund t'i kërkojë Huamarrësit të paguajë një depozitues të një institucioni financiar anëtar;

F) çdo ndryshim për tarifën e pagueshme Huamarrësit nga një ose të gjitha institucionet financiare anëtare; dhe

G) çdo ndryshim në politikën e investimeve.

2) Hollësitë e pagesave të kryera në përmbushje të detyrimeve të veta kundrejt depozitave të siguruara në pajtim me LDI-në në lidhje me një institucion financiar anëtar, duke iu nënshtruar detyrimeve ligjore të konfidencialitetit që rrjedhin nga ligjet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.



3) Një deklaram të shkurtër mbi gjendjen e përputhshmërisë të secilit prej detyrimeve që gjenden në Marrëveshjen e Huas.

4) Një raport, në formë dhe objekt të pranueshëm për BERZH-in, mbi zbatimin nga Huamarrësi të kërkesave 2 të performancës së BERZH-it.

b) Huamarrësi paraqet menjëherë raport për çdo ndryshim të një termi ose dispozite të LDI-së dhe ligjit për bankat dhe ligjit për SCA-në.

c) Në rast se Huamarrësi ka tërhequr një shumë sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi i paraqet Bankës raporte periodike që mund të kërkojnë nga Banka herë pas here, në lidhje me përdorimin e fondeve të tërhequra sipas kësaj Marrëveshjeje, shumat që Huamarrësi ka paguar në lidhje me depozitat e siguruara në lidhje me secilën dhe çdo rast sigurimi dhe shumën e plotë të të gjitha depozitave të siguruara në lidhje me një rast sigurimi të paguar dhe/ose që duhet të paguhet, të gjitha në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

d) Menjëherë pas ndodhjes së një incidenti që mund të ndikojë në masë të konsiderueshme tek pozicioni financiar i Huamarrësit ose një zhvillimi apo rasti të çdo lloji që i kërkon Huamarrësit të paguajë në përmbushje të detyrimeve të saj kundrejt depozitave të siguruara në pajtim me LDI-në të një institucioni anëtar financiar, Huamarrësi i bën njoftim Bankës nëpërmjet transmetimit me faks, duke specifikuar natyrën e këtij incidenti dhe çdo hap që Huamarrësi po ndërmerr për ta korrigjuar, sipas rastit, në përmbushje të detyrimeve ligjore të Huamarrësit për konfidencialitet që rrjedh nga ligjet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave.

Seksioni 3.03. Detyrime të tjera pohuese të Projektit në lidhje me Garantuesin

a) Huamarrësi i jep Garantuesit një kopje origjinale të nënshkruar të Marrëveshjes së Huas.

b) Huamarrësi njofton Garantuesin për të gjitha kërkesat e bëra nga Huamarrësi për Bankën për disbursime, amendime, heqje dorë ose pëlqime.

Neni 4

Detyrimet financiare dhe operacionale

Seksioni 4.01. Regjistrat dhe raportet financiare

a) Huamarrësi mban në fuqi procedura, regjistra dhe llogari të përshtatshme për të reflektuar, në pajtim me standardet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht dhe të zbatuara në mënyrë të njëtrajtshme, operacionet dhe gjendjen financiare të Huamarrësit dhe filialeve të tij, sipas rastit, dhe të përshtatshëm për të monitoruar dhe regjistruar përparimin e Projektit (duke përfshirë koston dhe përfitimet e nxjerra prej tij).

b) Huamarrësi:

A) realizon auditimin e regjistrave, të llogarive dhe pasqyrave financiare të tij (duke përfshirë bilancin, pasqyrat e të ardhurave dhe pasqyrën e ndryshimeve në gjendjen financiare dhe shënimet për këtë), dhe regjistrave, llogarive dhe pasqyrave financiare të filialeve të tij çdo vit financiar nga auditë të pavarur në pajtim me IRFS (2) i paraqet Bankës sapo të jetë e disponueshme, por në asnjë rast jo me vonë se katër muaj nga fundi i çdo viti fiskal:

A) kopje të certifikuara të pasqyrave financiare për çdo vit të tillë fiskal të audituar në këtë mënyrë;

B) informacion mbi depozitat e institucioneve financiare anëtare; dhe

C) informacion mbi portofolin e fondeve të disponueshme për Huamarrësin, në rast se Huamarrësit i kërkohej t'u paguajë depozituesve të një institucioni financiar anëtar; dhe

3) i paraqet Bankës çdo informacion tjetër në lidhje me këto regjistra, llogari dhe pasqyra financiare që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

c) Huamarrësi e njofton Bankën në rastin kur Huamarrësi vendos të rrisë/ndryshojë nivelin e mbulimit të sigurimit për depozitues për një shumë mbi 100.000 euro.

Seksioni 4.02. Detyrimet negative

a) Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, nuk ndërmerr asnjë nga veprimet e mëposhtme dhe i paraqet Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1) lidhja e një marrëveshjeje apo mase për të garantuar ose në një mënyrë apo me kushte të bëhet e detyrueshme për të gjithë ose një pjesë të një detyrimi financiar ose tjetër të një personi tjetër, duke përfshirë një filial ose partner apo



institucion financiar anëtar të ndryshëm nga sa kërkohet në pajtim me LDI-në në rastin kur institucioni financiar anëtar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e veta financiare ndaj depozitave të siguruara;

2) hyrja në një transaksion me një person përveçse në ushtrim të biznesit, sipas termave të zakonshëm tregtare ose mbi bazën e masave të mundësive të zakonshme apo themelimi i një agjencie të vetme ose ekskluzive të blerjeve ose shitjeve, ose hyrja në një transaksion ku Huamarrësi mund të paguajë më shumë se çmimi i zakonshëm tregtar për një blerje ose mund të marrë më pak se çmimi i plotë tregtar i fabrikës (në përputhje me skontot normale tregtare) për produktet ose shërbimet e veta;

3) shitja, dhënia me qira apo disponimi ndryshe i ndonjë prej sendeve të veta pasurore që kërkohet për përmbushjen efiçente të operacioneve të veta apo disponimi i të cilit mund të dëmtojë aftësinë e tij për të përmbushur normalisht ndonjë prej detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Huas, të ndryshme nga ushtrimi normal i aktivitetit të biznesit kur Huamarrësi kërkon likuiditet me qëllim që të përmbushë detyrimet e tij sipas LDI-së;

4) ndërmarrja ose lejimi i një bashkimi, konsolidimi apo riorganizimi;

5) ulja e tarifave që i paguhen Huamarrësit nga ose të gjitha institucionet financiare anëtare të ndryshme nga ato të parashikuara nga LDI-ja;

6) ndryshimi i nivelit të mbulimit me sigurim për depozitat e çdo shume mbi 100 000 euro;

7) investimi i sendeve pasurore të Huamarrësit të ndryshme nga parashikimi i LDI-së; dhe

8) ndryshimi i politikës së investimeve.

b) Huamarrësi, përveç kur ai njofton Bankën të paktën 30 ditë para, nuk ndërmerr asnjë nga veprimet e mëposhtme dhe i paraqet Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1) lidhja e një kontrate menaxhimi apo mase tjetër të ngjashme ku biznesi ose operacionet e tij të menaxhohen nga një person tjetër, duke përfshirë një filial apo partner; ose

2) themelimi i një filiali.

c) Huamarrësi nuk jep dhe nuk lejon ekzistencën e huave apo paradhënies, ose depozitave (përveç depozitave në ushtrim të

zakonshëm të biznesit me banka të njohura) me persona të tjerë ose investimet tek një person i caktuar, duke përfshirë një filial ose partner (Investimi); megjithatë, me kusht që Huamarrësi të jetë i lirë të kryejë çdo investim në pajtim me politikën e investimeve (që mund të ndryshojë herë pas here) dhe me kusht që një kopje e saj t'i jepet Bankës.

d) Huamarrësi përfaqëson dhe garanton që angazhimet e mësipërme të Huamarrësit të jenë plotësisht në pajtim me ligjin shqiptar dhe veçanërisht me LDI-në.

Seksioni 4.03. Detyrime të tjera financiare

Pa kufizuar përgjithësimin e seksionit 4.02, Huamarrësi, gjatë të gjithë kohës së periudhës së disponibilitetit të Huas, ruan një raport mbulimi jo më të lartë se 6% e depozitave të siguruara, ku "raport mbulimi" do të thotë raporti i shumës së fondit të Huamarrësit të kompensimit të depozitave (ku ky term është i përkufizuar në ligjin për sigurimin e depozitave) plus shumën e disponueshme të Huas të pjesëtuar me depozitat e siguruara.

Seksioni 4.04. Zhvillimi i biznesit dhe operacioneve

Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

a) E zhvillon biznesin dhe operacionet e tij në pajtim me standardet dhe praktikën e njohura ndërkombëtarisht administrative, financiare, inxhinierike dhe të tjera përkatëse dhe duke marrë parasysh rregullisht politikën kryesore operacionale;

b) Merr menjëherë të gjitha masat brenda kompetencave të veta për të ruajtur ekzistencën e vetë ligjore për të vazhduar operacionet e saj dhe për të përfutur, ruajtur dhe rinovuar të gjitha të drejtat, pronat, kompetencat, privilegjet dhe licencat që janë të nevojshme për të zhvilluar biznesin, duke përfshirë përmbushjen e Projektit;

c) Njofton menjëherë Bankën për çdo propozim për të ndryshuar, pezulluar ose anuluar një dispozitë të statutit dhe i ofron Bankës një mundësi të përshtatshme për të komentuar një propozim të tillë para se të ndërmarrë ndonjë masë për këtë qëllim.

Neni 5

Pezullimi, përshpejtimi, anulimi

Seksioni 5.01. Pezullimi

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e



seksionit 7.01(a)(xvii) të Termave dhe Kushteve Standarde:

a) Çdo ndryshim në LDI, ligjin për bankat, ligjin për SCA-në e Republikës së Shqipërisë që mund të ndikojnë negativisht tek operacionet e Huamarrësit, duke përfshirë, por pa u kufizuar te detyrimet potenciale të Huamarrësit dhe renditjen e pretendimeve të Huamarrësit dhe të depozituesve në lidhje me depozitat e siguruara pas ndodhisë së rastit të sigurimit, e ndryshme nga sa është aprovuar nga Banka me shkrim; ose

b) Statuti është ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë prej tij.

Seksioni 5.02. Anulimi nga Huamarrësi

Në rastin e një anulimi nga Huamarrësi, në pajtim me nënseksionin (a) të seksionit 7.02 të Termave dhe Kushteve Standarde, Huamarrësit nuk i kërkohet të paguajë tarifën e anulimit prej një të tetën e një për qind (0,125%) të shumës principale të Huas që anulohet në rast se ky anulim bëhet vetëm për të ruajtur përputhshmërinë me seksionin 4.03 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Seksioni 6.01. Kushtet paraprake për hyrjen në fuqi

Sa më poshtë, specifikohen për qëllimet e seksionit 9.02(c) të Termave dhe Kushteve Standarde si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Garancisë:

a) Marrëveshja e Garancisë do të ratifikohet nga (Këshilli i Ministrave i Qeverisë së Shqipërisë) dhe është në fuqi dhe efekt të plotë.

b) LDI-ja është në fuqi dhe efekt të plotë.

Seksioni 6.02. Opinionet ligjore

a) Për qëllimet e seksionit 9.03(a) të Termave dhe Kushteve Standarde, opinionin ose opinionet e këshilltarëve jepen në emër të Garantuesit kryesisht në formën e grafikut 2.

b) Për qëllimet e seksionit 9.03(b) të Termave dhe Kushteve Standarde, opinionin ose opinionet e këshilltarëve jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03. Zgjidhja për shkak të moshyrjes në fuqi

Data, 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, specifikohet për qëllimet e seksionit 9.04 të Termave dhe Kushteve Standarde.

Neni 7

Të ndryshme

Seksioni 7.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimet e seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standarde:

Për Huamarrësin:

Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave
(Adresa)

Në vëmendje të: (_____)

Faks:(_____)

Teleks:(_____)

Përgjigje: (_____)

Për Bankën:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Njësia e Administrimit të Operacioneve

Faks:+44-20-7338-6100

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në katër koje dhe është shpallur në Tiranë në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

AGJENCIA SHQIPTARE E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Nga:_____

Emri:

Titulli:

BANKA EUROPIANE

PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:_____

Emri:

Titulli: GRAFIKU 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTT

1. Qëllimi i Projektit është t'i ofrojë Huamarrësit likuiditet dhe të asistojë Huamarrësin për përmbushjen e detyrimeve të veta ligjore që rrjedhin nga një rast sigurimi për të paguar ose transferuar në lidhje me depozitat e siguruara në pajtim me LDI-në në Shqipëri.



2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, në pajtim me ato ndryshime, për të cilat Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A: Linjë kredie e gatshme prej 100 milionë euro

3. Projekti pritet të përfundohet brenda dhjetorit 2024.

GRAFIKU 2
FORMULARI I OPINIONIT LIGJOR
TË HUAMARRËSIT

(Të shkruhet në kokën e letrës së Huamarrësit)

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

(Datë)

Zonja dhe zotërinj,

Lënda: Opinion ligjor për Marrëveshjen e Huas ndërmjet (vendosni emrin e plotë ligjor të Huamarrësit siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në lidhje me Huan për Projektin (vendosni emrin e Projektit siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas).

Në datën (vendosni datën e Marrëveshjes së Huas), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) lidhi një marrëveshje huaje (Marrëveshja e Huas) me (vendosni emrin e plotë ligjor të Huamarrësit siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas) (Huamarrësi) për të asistuar për financimin e (vendosni emrin e Projektit siç paraqitet në Marrëveshjen e Huas) Projektit (Projekti), duke i dhënë një hua në shumën e (vendosni shumën dhe monedhën e Huas siç shfaqet në Marrëveshjen e Huas).

Në të njëjtën datë, duke patur parasysh që Banka lidhi një Marrëveshje Huaje (vendosni emrin e plotë sovran të anëtarit të BERZH-it siç shfaqet në Marrëveshjen e Garancisë) (Garantuesi) lidhi një marrëveshje garancie (Marrëveshje e Garancisë) me Bankën.

Termat e përkufizuar në Marrëveshjen e Huas përdoren në këtë letër siç përkufizohen në Marrëveshjen e Huas.

Në pajtim me seksionin 9.02(a) të Termave dhe Kushteve Standarde, Marrëveshja e Huas

dhe Marrëveshja e Garancisë nuk hyn në fuqi derisa Bankës t'i paraqiten prova, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, që nënshkrimi dhe shpallja e Marrëveshjes së Huas në emër të Huamarrësit është autorizuar ose ratifikuar rregullisht nga veprimet e nevojshme qeveritare ose korporative. Në pajtim me seksionin 9.03(a) të Termave dhe Kushteve Standarde, si pjesë e këtyre provave, Huamarrësit i kërkohet të paraqesë ose të marrë masa për paraqitjen në Bankë të një opinionit ose opinionëve ligjore (në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën), nga këshilltarë të pranueshëm për Bankën, duke treguar ndër të tjera që Marrëveshja e Huas është autorizuar ose ratifikuar rregullisht dhe është nënshkruar dhe shpallur në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjorisht detyrues të Huamarrësit, të ekzekutueshëm në pajtim me kushtet e saj.

Në pajtim me seksionin (6.02) të Marrëveshjes së Huas, ky opinion ligjor duhet të paraqitet në emër të Huamarrësit nga (vendosni titullin e nëpunësit që paraqet opinionin).

Në cilësinë time si (vendosni titullin e nëpunësit që paraqet opinionin) i Huamarrësit, unë kam këqyrur kopjen e nënshkruar të Marrëveshjes së Huas dhe të gjithë dokumentacionin tjetër, kam shqyrtuar ato ligje, rregullore, dokumente dhe të tjera dhe kam bërë hetime të tjera që i konsideroj të nevojshme dhe të përshtatshme për qëllimet e këtij mendimi. Bazuar në sa më sipër, unë jam i mendimit dhe deklaroj përkatësisht që:

a) Huamarrësi është themeluar sipas (citoni ligjin, rregulloren, dekretin ose rezolutën përkatëse të Garantuesit që ka themeluar Huamarrësin) dhe ekziston në mënyrë të vlefshme sipas ligjeve të Garantuesit me kompetencën për të marrë detyrime sipas Marrëveshjes së Huas.

b) Më (vendosni datën e rezolutës së organit qeveritar të Huamarrësit që aprovon Marrëveshjen e Huas), (vendosni emrin e plotë të ligjshëm të organit qeveritar të Huamarrësit të autorizuar për të aprovuar Marrëveshjen e Huas) të Huamarrësit, në pajtim me kompetencat e veta bazuar në (citoni dispozitën përkatëse të dokumentit ose ligjit themelues të Huamarrësit që autorizon organin qeveritar të Huamarrësit të aprovojë Marrëveshjen e Huas), vendosi që:



1) teksti i Marrëveshjes së Huas është aprovuar nga Huamarrësi;

2) përmbushja e Marrëveshjes së Huas është autorizuar nga Huamarrësi; dhe

3) (vendosni emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit i cili ka nënshkruar Marrëveshjen e Huas) është i autorizuar të nënshkruajë dhe shpallë Marrëveshjen e Huas në emër të Huamarrësit.

c) Bashkëlidhur është një përkthim në përputhje me origjinalin dhe i saktë në gjuhën angleze (citoni rezolutën e organit qeveritar të Huamarrësit që aprovon Marrëveshjen e Huas) që autorizon dhe konfirmon çështjet e përmendura në paragrafin e mësipërm dhe kjo rezolutë është në fuqi të plotë dhe nuk është ndryshuar.

d) Në (vendosni vendin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Huas) më (vendosni datën e Marrëveshjes së Huas), Marrëveshja e Huas është nënshkruar dhe shpallur rregullisht (vendosni emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit që ka nënshkruar Marrëveshjen e Huas) në emër të Huamarrësit në pajtim me (citoni rezolutën e organit qeveritar të Huamarrësit që ka aprovuar Marrëveshjen e Huas).

Sa më sipër, përfundimi im është që Marrëveshja e Huas është autorizuar ose ratifikuar rregullisht, dhe nënshkruar dhe shpallur në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërishëm detyrues për Huamarrësin, të ekzekutueshëm në pajtim me kushtet e saj.

Bashkëlidhur janë përkthime të vërteta dhe të sakta në gjuhën angleze të dispozitave përkatëse të (citoni çdo ligj, rregullore, dekret ose rezolutë të Garantuesit dhe rregullore, marrëveshje ose rezolutë të Huamarrësit të përmendur në këtë opinion) mbi bazën e të cilit është dhënë mendimi. Çdo dokument i tillë është në fuqi të plotë dhe nuk është ndryshuar.

Me respekt

(Vendosni emrin dhe titullin e nëpunësit që jep këtë opinion)

(Rendisni shtojcat)

GRAFIKU 3

FORMULARI I KËRKESËS PËR TËRHEQJE

Drejtuar: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, _____¹

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Njësia e Administrimit të Operacioneve

Lënda: Marrëveshje huaje, datë ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave dhe Agjencisë Shqiptare për Sigurimin e Depozitave (Huamarrësi).

Monedha dhe shuma e Huas: 100 milionë euro

Numri i operacionit: 45446

Numri i aplikimit: _____

Ne kërkojmë disbursimin e mëposhtëm në llogarinë e specifikuar më poshtë në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Huas të përmendur më sipër:

Monedha e Huas: euro

Shuma e kërkuar²: euro _____

Monedha e pagesës: euro _____

Data e vlerës³: _____

Udhëzime për pagesën (hollësi bankare):

Emri i llogarisë së marrësit:

Numri i llogarisë së Marrësit:

Emri i Bankës së Marrësit: _____

Adresa e Bankës së Marrësit: _____

Referenca të pagesës (sipas rastit)⁴: _____

Ne specifikojmë dhe përfaqësojmë që:

a) një "Rast i sigurimit" i përkufizuar në LDI ka ndodhur në lidhje me institucionin(et) financiar anëtarë më poshtë:

Emri: _____

Data: _____

¹ Vendosni datën e kërkesës.

² Përcaktoni shumën me shifra dhe fjalë.

³ Data që do të debitohet llogaria e BERZH-së

⁴ Nëse nuk ka, BERZH-i do të specifikojë Emrin e Huamarrësit.



b) shumat që Huamarrësit i kërkohet të paguajë vlerësohen të jenë:⁵ _____

d) ne nuk kemi kërkuar⁶ më parë disbursime në lidhje me rastin e mësipërm të sigurimit;

e) të ardhurat nga disbursimi do të zbatohen për Projektin në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Huas;

f) Huamarrësi është në përmbushje të detyrimeve të tij sipas parashikimit në Marrëveshjen e Huas; dhe

g) asnjë rast nuk ka ndodhur, i cili mund të ndikojë negativisht dhe në dëm të gjendjes financiare të Huamarrësit ose aftësisë së tij për të përmbushur një prej detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Huas.

Termat e përkufizuar në Marrëveshjen e Huas kanë këtu të njëjtin kuptim.

Me respekt

Nga dhe në emër të Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave.

Emri dhe nënshkrimi: _____

Titulli _____

Bashkëlidhur: Numri i plotë i faqeve të përmbledhjes: _____

LIGJ
Nr. 145/2014

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË TRAKTATIN PËR SISTEMIN EUROPIAN TË INFORMACIONIT PËR AUTOMJETIN DHE LEJEN E DREJTIMIT (EUCARIS)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Traktatin për Sistemin European të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit (EUCARIS).

⁵ Shprehni shumën në shifra dhe fjalë; dhe nëse do të kërkohet të paguhen depozitues drejtpërdrejt apo të transferohen fondet për një blerje dhe prezumimet/banka ndërlihdhëse

⁶ Fshini atë që nuk zbatohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8783, datë 12.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

TRAKTAT

NË LIDHJE ME SISTEMIN EVROPIAN TË INFORMACIONIT PËR AUTOMJETIN DHE LEJEN E DREJTIMIT (EUCARIS)

Mbretëria e Belgjikës, Republika Federale e Gjermanisë, Dukati i Madh i Luksemburgut, Mbretëria e Holandës, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda e Veriut; më poshtë të quajtura “Palë kontraktuese”,

Duke vlerësuar se është detyrë e autoriteteve qendrore përgjegjëse për regjistrimin e të dhënave për automjetet dhe lejet e drejtimit, të kontribuojnë në parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve kundër rregullave të Shteteve individuale;

Duke njohur nevojën për shkëmbimin reciprok efektiv të informacioneve në lidhje me të dhënat e lejeve të drejtimit, me qëllim që të garantohet se individët janë kualifikuar për të drejtuar automjetet në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare;

Duke njohur gjithashtu nevojën për shkëmbimin reciprok efektiv të informacioneve për të dhënat e automjeteve, me qëllim që të garantohet se automjetet janë licencuar dhe/ose regjistruar sipas rregullave për përdorim në rrugë;

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë e mbajtjes së të dhënave të sakta për automjetet dhe lejet e drejtimit që mund të përdoren në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve të kryera;

Duke marrë në konsideratë se siguria publike kërcënohet ndjeshëm nga rritja e krimeve ndërkombëtare në lidhje me automjetet;

Të bindur se bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve qendrore përgjegjëse për regjistrimin e të dhënave të automjeteve dhe lejeve të drejtimit duhet të forcohet nëpërmjet përcaktimit të procedurave që u japin mundësinë këtyre autoriteteve të koordinojnë veprimet e tyre dhe



të shkëmbejnë të dhëna personale dhe të tjera në lidhje me regjistrimin e automjeteve dhe lejet e drejtimit me ndihmën e menaxhimit të të dhënave të reja dhe teknologjisë së transmetimit të të dhënave;

Duke marrë në konsideratë dispozitat për mbrojtjen e të dhënave të direktivës 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 24 tetor 1995;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I PËRKUFIZIME

Neni 1

Në këtë Traktat termat:

1) "Palë" nënkupton çdo palë të Traktatit, d.m.th. palën kontraktuese ose palën që ka aderuar në Traktat;

2) "Autoritete qendrore të regjistrimit" nënkupton autoritetet e palëve që janë përgjegjëse për menaxhimin e regjistrave qendrorë të automjeteve dhe lejeve të drejtimit;

3) "Rregullat kombëtare" nënkupton të gjitha rregullat ligjore dhe administrative të një pale për zbatimin e të cilave janë tërësisht ose pjesërisht përgjegjës autoritetet qendrore të regjistrimit të kësaj pale, në lidhje me:

a) dhënien e lejes ose regjistrimit të automjeteve; dhe

b) lëshimin dhe regjistrimin e lejeve të drejtimit;

4) "Të dhëna personale" nënkupton çdo informacion për një person të veçantë ose që mund të identifikohet.

KAPITULLI II

NGRITJA E SISTEMIT EVROPIAN TË INFORMACIONIT PËR AUTOMJETIN DHE LEJEN E DREJTIMIT (EUCARIS)

Neni 2

1) Autoritetet qendrore të regjistrimit duhet të ndërtojnë dhe ruajnë një sistem të përbashkët për shkëmbimin e të dhënave për automjetet dhe lejet e drejtimit, më poshtë i quajtur "Sistemi Evropian i Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit", i njohur si EUCARIS.

2) Qëllimi i Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit është:

i) të sigurojë se regjistrat qendrorë të automjeteve dhe lejet e drejtimit janë të saktë dhe të sigurt;

ii) të ndihmojë në parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve ligjore të shteteve individuale në fushën e lejeve të drejtimit, regjistrimit të automjetit si dhe mashtrimeve dhe krimeve të tjera në lidhje me automjetet; dhe

iii) të shkëmbejë informacione me shpejtësi, me qëllim rritjen e efikasitetit të masave administrative që merren nga autoritetet përkatëse sipas rregullave ligjore dhe administrative të palëve.

KAPITULLI III

FUNKSIONIMI DHE ZBATIMI I SISTEMIT EVROPIAN TË INFORMACIONIT PËR AUTOMJETIN DHE LEJEN E DREJTIMIT

Neni 3

Në kuadrin e Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit, autoritetet qendrore të regjistrimit duhet të lejojnë njëri-tjetrin të përdorin një pjesë të përzgjedhur të të dhënave të ruajtura në regjistrat qendrorë të automjeteve dhe lejeve të drejtimit të palëve.

Për këtë qëllim, çdo autoritet qendror regjistrimi duhet të ketë harduerin e tij, i cili duke përdorur një softuer të përbashkët, lejon hyrjen në të dhënat e regjistrave të tij qendrorë të automjeteve dhe lejeve të drejtimit për arritjen e qëllimit të Traktatit dhe ofron mundësinë e përdorimit të të dhënave të regjistrave të automjeteve dhe lejeve të drejtimit të palëve të tjera.

Neni 4

Në mënyrë që të arrijnë qëllimin e përcaktuar në nenin 2, paragrafi 2, autoritetet qendrore të regjistrimit, duke përdorur procedura të automatizuara, duhet të tërheqin të dhënat e përmendura në nenet 3 dhe 5 nga regjistrat qendrorë të automjeteve dhe lejeve të drejtimit për të kryer detyrat e mëposhtme:

a) Regjistri qendror i automjeteve

Nëse aplikimi për të regjistruar një automjet është bërë në zonën e përgjegjësisë së një autoriteti qendror regjistrimi dhe nëse ky automjet është regjistruar më parë në zonën e përgjegjësisë të një autoriteti tjetër qendror regjistrimi, informacioni i paraqitur nga aplikanti duhet të kontrollohet me



informacionin e marrë nga regjistri qendror i automjetit të palës, në territorin e së cilës ky automjet është regjistruar më parë.

Nëse informacioni i paraqitur nga aplikanti çon në konkluzionin se automjeti është regjistruar në territorin e një pale tjetër, informacioni i paraqitur nga aplikanti duhet të kontrollohet gjithashtu me informacionin e marrë nga regjistri qendror i automjetit të kësaj pale.

b) Regjistri qendror i lejeve të drejtimit

Nëse aplikimi për leje drejtimi është bërë në zonën e përgjegjësive të një autoriteti qendror regjistrimi, ky autoritet, nëpërmjet inspektimit të informacioneve në regjistrat qendrorë të palëve të tjera, mund të kontrollojë nëse aplikantit i është lëshuar në të shkuarën një leje drejtimi që është ende e vlefshme.

E njëjta procedurë duhet të ndiqet nëse aplikimi është bërë për zëvendësimin ose shkëmbimin e lejes së drejtimit që është lëshuar në zonën e përgjegjësive të një autoriteti tjetër qendror regjistrimi.

Nëse një leje drejtimi që është lëshuar në zonën e përgjegjësive të një autoriteti tjetër qendror regjistrimi i paraqitet për regjistrim një autoriteti qendror regjistrimi, atëherë kryhet kontrolli i të dhënave me informacionin e marrë në regjistrin qendror të regjistrimit të palës, në territorin e së cilës është lëshuar leja e drejtimit.

Neni 5

1) Të dhënat e mëposhtme janë në dispozicion për ruajtje nëpërmjet procedurës së automatizuar të përdorur nga autoritetet qendrore të regjistrimit:

a) Regjistri qendror i automjeteve:

- i) prodhuesi (dhe modeli, nëse ka);
- ii) numri i identifikimit të automjetit;
- iii) numri i regjistrimit;
- iv) data e regjistrimit të parë;
- v) lloji i lëndës djegëse dhe/ose lloji i timonit;
- vi) konfirmimi i vjedhjes.

b) Regjistri qendror i lejes së drejtimit:

- i) numri i dokumentit dhe/ose numri i lejes së drejtimit;
- ii) mbiemri ose mbiemri i lindjes, emri;
- iii) data dhe vendi i lindjes;
- iv) kategoritë;
- v) kushtet dhe kufizimet;
- vi) periodha e vlefshmërisë;

vii) përjashtimi, tërheqja, ndalimi i drejtimit, konfiskimi dhe arrestimi;

viii) data e lëshimit.

2) Marrëveshjet në lidhje me tërheqjen e informacioneve të tjera nga autoritetet qendrore të regjistrimit në kuadrin e rregullave kombëtare, nuk janë cenuar.

Neni 6

Në mënyrë që të arrihet qëllimi i përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2, autoritetet qendrore të regjistrimit, në përputhje me rregullat kombëtare të palëve, duhet të planifikojnë masat që do të merren për të qartësuar situatën para marrjes së masave të mëtejshme administrative, nëse ekziston ndonjë dyshim për kushtet aktuale ose ligjore të automjeteve ose lejeve të drejtimit.

Këto masa duhet të merren në rastet e mëposhtme:

a) Regjistri qendror i mjetit:

i) nëse informacioni i paraqitur nga aplikanti gjatë procesit për regjistrim nuk mund të gjendet në regjistrin qendror të automjetit të palës në territorin e së cilës mendohet se automjeti është regjistruar më parë;

ii) nëse informacioni i paraqitur nga aplikanti gjatë procesit për regjistrim është i ndryshëm nga informacioni i mbajtur në regjistrin qendror të automjetit të palës, në territorin e së cilës mendohet se automjeti është regjistruar më parë;

iii) nëse sipas informacionit të ruajtur në regjistrin qendror të automjetit të njëres nga palët, automjeti që aplikohet për regjistrim është raportuar i vjedhur.

b) Regjistri qendror i lejes së drejtimit:

i) nëse gjatë procesit për zëvendësimin, shkëmbimin ose regjistrimin e lejes së drejtimit, deklarohet se sipas informacionit të ruajtur në regjistrin qendror të lejes së drejtimit të njëres nga palët, në emër të aplikantit është lëshuar më parë një leje e vlefshme drejtimi;

ii) nëse gjatë procesit për zëvendësimin, shkëmbimin ose regjistrimin e lejes së drejtimit, informacioni i paraqitur nga aplikanti nuk mund të gjendet në regjistrin qendror të lejes së drejtimit të palës, në territorin e së cilës është lëshuar ose ndryshuar leja e drejtimit;

iii) nëse gjatë procesit për zëvendësimin, shkëmbimin ose regjistrimin e lejes së drejtimit, deklarohet se sipas informacionit të ruajtur në



regjistrin qendror të lejes së drejtimit të njëjës nga palët, mbajtësi i lejes përjashtohet ose ndalohet dhe/ose licenca e tij është tërhequr, konfiskuar ose mbajtur .

Neni 7

1. Nëse një automjet që është regjistruar më parë në territorin e njëjës prej palëve, regjistrohet në territorin e një pale tjetër, autoriteti qendror i regjistrimit njofton menjëherë autoritetin qendror të regjistrimit të palës, në territorin e së cilës është regjistruar automjeti për herë të fundit. Të dhënat në regjistrin e automjetit të përmendur në nenin 5 jepen së bashku me datën e regjistrimit.

2. Nëse një leje drejtimi që është lëshuar në territorin e njëjës nga palët zëvendësohet, shkëmbehet ose regjistrohet në territorin e një pale tjetër, autoriteti qendror i regjistrimit njofton menjëherë autoritetin qendror të regjistrimit të palës që ka lëshuar lejen e drejtimit. Të dhënat në regjistrin e lejes së drejtimit të përmendur në nenin 5 jepen së bashku me datën e zëvendësimit, shkëmbimit ose regjistrimit.

Neni 8

1. Aksesit i drejtpërdrejtë në të dhënat e ruajtura për tërheqje sipas Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit, është detyrë e autoriteteve qendrore të regjistrimit të palëve përkatëse.

2. Në emër të palës së tyre, këto autoritete janë përgjegjëse për funksionimin e saktë të Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit, dhe duhet të marrin masat përkatëse për të garantuar respektimin e dispozitave të Traktatit.

Neni 9

Informacioni i transmetuar sipas Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit mund t'i përcillet nga autoritetet qendrore të regjistrimit, në përputhje me rregullat e palëve, në mënyrë që të arrihet qëllimi i përcaktuar në nenin 2, paragrafi 2, autoriteteve administrative përgjegjëse për regjistrimin e automjeteve dhe lëshimin dhe regjistrimin e lejeve të drejtimit.

Në pajtim me rregullat kombëtare të palëve, ky informacion mund t'i përcillet vetëm policisë, doganave, prokurorisë dhe organeve të sigurisë kombëtare, në mënyrë që të arrihet qëllimi i përcaktuar në nenin 2, paragrafi 2. Në asnjë rast ky informacion nuk i përcillet ndonjë organi apo organizate tjetër.

Neni 10

Autoritetet qendrore të regjistrimit duhet të garantojnë se të gjitha dokumentet e autoriteteve të tjera qendrore të marra janë të pavlefshme, janë shkatërruar ose i janë kthyer autoritetit përkatës, në përputhje me rregullat e palëve.

KAPITULLI IV MBROJTA E TË DHËNAVE

Neni 11

1. Palët duhet të përdorin informacionin e transmetuar sipas Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit, vetëm për arritjen e qëllimit të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2.

2. Informacioni duhet të përdoret vetëm në përputhje me rregullat vendase të palëve nëse Traktati nuk përmban rregulla më të rrepta.

Neni 12

Nëse informacioni shkëmbehet ndërmjet autoriteteve qendrore të regjistrimit sipas Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit, autoriteti qendror i regjistrimit që jep informacionin duhet të informohet për kërkesën e përdorimit të këtij informacioni, si dhe për masat që do të merren më pas.

Neni 13

Autoriteti qendror i regjistrimit që jep informacionin duhet të sigurojë saktësinë e informacionit që jepet dhe nëse ky informacion është i nevojshëm dhe në përputhje me qëllimin për të cilin jepet. Në këtë rast duhet të respektohen rregullat përkatëse vendase për sigurimin e të dhënave.

Nëse rezulton se informacioni që duhej paraqitur është i pasaktë ose informacion që nuk duhet të ishte paraqitur, njoftohet menjëherë autoriteti qendror i regjistrimit që ka marrë informacionin. Autoriteti qendror i regjistrimit që



ka marrë informacionin duhet të fshijë ose korrigojë informacionin e marrë.

Neni 14

Personi në fjalë duhet të informohet për informacionin e dhënë për të dhe, me kërkesën e tij, për përdorimin e tij. Dhënia e këtij informacioni nuk është e detyrueshme, nëse sipas rregullave kombëtare, vlerësohet se interesi publik në mosdhënien e tij është më i rëndësishëm se interesi i personit në fjalë të cilit i jepet informacioni. Përveç kësaj, e drejta e personit në fjalë për ta njoftuar për informacionin që i është vënë në dispozicion, rregullohet nga rregullat vendase të palës në territorin e të cilës është kërkuar ky informacion.

Neni 15

Në masën që rregulloret kombëtare të zbatueshme për autoritetin qendror të regjistrimit që jep informacionin, caktojnë periudha të veçanta për fshirjen e informacionit personal që është dhënë, autoriteti qendror i regjistrimit që ka dhënë informacionin njofton marrësin e informacionit sipas rrethanave. Pavarësisht nga këto periudha, informacioni personal që është dhënë duhet të fshihet menjëherë pasi nuk është më i nevojshëm për qëllimin për të cilin është dhënë.

KAPITULLI V SIGURIA E SISTEMIT EUROPIAN TË INFORMACIONIT PËR AUTOMJETIN DHE LEJEN E DREJTIMIT

Neni 16

1. Autoritetet qendrore të regjistrimit duhet të marrin masat e nevojshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave në kontekstin e Traktatit.

2. Në veçanti, masat duhet të merren:

- i) për të parandaluar persona të paautorizuar që të përdorin mjetet e përpunimit të të dhënave;
- ii) për të parandaluar leximin, kopjimin, ndryshimin ose fshirjen e informacionit nga persona të paautorizuar;
- iii) për të parandaluar marrjen në pyetje apo transmetimin në mënyrë të paautorizuar të informacionit;
- iv) për të parandaluar leximin apo kopjimin e paautorizuar të informacionit gjatë transmetimit.

Neni 17

Autoritetet qendrore të regjistrimit duhet të garantojnë përgatitjen e procesverbaleve dhe që këto procesverbale të mbajtura, të tërhequra nga autoritetet qendrore të regjistrimit të palëve, të jenë në përputhje me kërkesat kombëtare për mbrojtjen e të dhënave.

Këto procesverbale duhet:

- i) të përmbajnë shkakun e tërheqjes, detaje të informacionit të tërhequr si dhe datën dhe kohën e tërheqjes;
- ii) të përdoren vetëm për qëllime kontrolli;
- iii) të mbrohen siç duhet kundër keqpërdorimit dhe keqpërdorimeve të tjera dhe të fshihen pas dymbëdhjetë muajve.

KAPITULLI VI MONITORIMI I MBROJTJES SË TË DHËNAVE

Neni 18

Sipas direktivës 95/46/KE, çdo Palë duhet të caktojë autoritetet e saj kombëtare mbikëqyrëse të cilat kanë për detyrë të monitorojnë në mënyrë plotësisht të pavarur përputhjen me dispozitat e Traktatit për mbrojtjen e të dhënave.

Organet mbikëqyrëse duhet të kryejnë mbikëqyrje dhe kontrole të pavarura në përputhje me rregullat e tyre të veçanta ligjore kombëtare, në mënyrë që të garantojnë se nuk janë shkelur të drejtat e personave në fjalë si pasojë e tërheqjes dhe përdorimit të informacionit. Për këtë qëllim, organet mbikëqyrëse mund të hyjnë në Sistemin Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit.

KAPITULLI VII ORGANIZIMI

Neni 19

1. Bordi përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve qendrore të regjistrimit të palëve. Çdo autoritet duhet të ketë një votë, pavarësisht nga numri i përfaqësuesve që çdo autoritet qendror regjistrimi i delegon Bordit.

Bordi miraton unanimitisht rezolutat për dispozitat e paragrafit 2 shkronja “a” dhe rezolutat për dispozitat e paragrafit 2 shkronja “b” me shumicë katër të pestat.



Bordi duhet të miratojë unanimitisht Rregullat Fillestare të Procedurës; ndryshimet e mëtejshme duhet të miratohen me shumicë katër të pestat.

2. Bordi është përgjegjës:

a) për implementimin dhe zbatimin e duhur të dispozitave të Traktatit;

b) për funksionimin e duhur teknik dhe operativ të Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit; në veçanti Bordi monitoron masat e marra nga autoritetet qendrore të regjistrimit në përputhje me nenin 16, paragrafi 2 për ruajtjen e sigurisë së informacionit.

3. Votat mund të hidhen me të drejtën e konfirmimit të mëvonshëm të rezervimit brenda maksimumi dy muajve.

4. Rezolutat e miratuara unanimitisht janë të detyrueshme për palët përkatëse në kuadrin e rregullave të tyre vendase.

5. Rezolutat e miratuara me shumicë votash kanë statusin e rekomandimeve për palët që kanë votuar kundër rezolutave.

Neni 20

1. Shpenzimet për funksionimin dhe zbatimin e Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit nga palët në territorin e tyre, mbulohen nga vetë pala e interesuar.

2. Në bazë të miratimit të mëparshëm të Bordit, shpenzimet e përbashkëta të kryera në zbatimin e Traktatit mbulohen nga palët në pjesë të barabarta.

KAPITULLI VIII PËRGJEGJËSIA DHE DETYRIMI

Neni 21

1. Nëse ndonjë person ka pësuar dëme si pasojë e përpunimit të paligjshëm të informacionit që ka lidhje me Traktatin, pala e autoritetit qendror të regjistrimit që ka marrë informacionin është përgjegjëse ndaj tij në përputhje me ligjin e saj vendas. Ajo nuk mund të lirohet nga përgjegjësia ndaj personit të dëmtuar duke u justifikuar se dëmi është shkaktuar nga autoriteti që ka transmetuar informacionin.

2. Nëse pala e autoritetit qendror të regjistrimit që ka marrë informacionin paguan kompensimin e shkaktuar nga përdorimi i informacionit të pasaktë ose të dhënë në mënyrë të pasaktë, kjo palë kërkon kompensim nga pala e autoritetit qendror të regjistrimit që ka dhënë informacionin.

3. Pala e autoritetit qendror të regjistrimit që ka dhënë informacionin mund të përjashtohet nga përgjegjësia, tërësisht ose pjesërisht, në qoftë se provon se nuk është përgjegjëse.

KAPITULLI IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 22

1. Për palët kontraktuese që kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose miratimit, Traktati hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes nga depozitari të depozitimit të instrumentit të katërt të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

2. Për palën e pestë kontraktuese, Traktati hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes nga depozitari të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 23

Çdo palë njofton depozitarin e autoritetit të saj kombëtar të regjistrimit përgjegjës për menaxhimin e regjistrave qendrorë të automjeteve dhe lejeve të drejtimit.

Neni 24

1. Çdo shtet që zbaton dispozitat për mbrojtjen e të dhënave të direktivës 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datë 24 tetor 1995, mund të aplikojë për të aderuar në Traktat.

2. Kjo kërkesë i bëhet depozitarit me shkrim dhe i nënshtrohet miratimit unanimit të palëve përkatëse.

3. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë depozitarit.

4. Për çdo shtet që aderon, Traktati hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës së depozitimit të instrumenteve të tij të aderimit nga shteti përkatës.

Neni 25

Depozitari i Traktatit është Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut. Ai njofton palët kontraktuese dhe aderuese për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo kërkesë për aderim të përmendur në nenin 24;

c) çdo depozitim të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;



- d) datën e hyrjes në fuqi për çdo palë;
- e) çdo njoftim për tërheqje nga Traktati;
- f) autoritetet kombëtare qendrore të regjistrimit të informuara sipas nenit 23.

Neni 26

1. Çdo palë mund të tërhiqet nga Traktati në çdo kohë pas dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të Traktatit për këtë palë.

2. Tërheqja bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim pranë depozitarit.

3. Çdo tërheqje e tillë hyn në fuqi një vit pas marrjes së njoftimit nga depozitari.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar sipas rregullave kanë nënshkruar këtë Traktat.

Hartuar në Luksemburg më 29 qershor 2000, në gjuhët holandisht, anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht, ku në katër tekstet janë njëllorj autentike, në një kopje origjinale e cila depozitohet pranë Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, e cila i transmeton një kopje të vërtetuar nga çdo palë kontraktuese dhe aderuese.

VENDIM

Nr. 701, datë 22.10.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE “PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR NË FUSHËN INDUSTRIALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 31, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 121, datë 2.2.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në fushën industriale”, shfuqizohet.

3. Ministrinë dhe institucionet shtetërore, në cilësinë e autoriteteve kontraktore, në mënyrë individuale, duhet që, brenda 60 (gjashtëdhjetë)

ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimet përkatëse për zbatimin e tij.

4. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLAT

PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR NË FUSHËN INDUSTRIALE

I. OBJEKTI DHE FUSHA E VEPRIMIT

Neni 1

Objekti i kësaj rregulloreje është:

a) Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet palëve për përcaktimin e masave mbrojtëse dhe procedurave të parandalimit nga përhapja e paautorizuar, humbja apo shkeljet e sigurisë së informacionit të klasifikuar, i cili trajtohet në kushtet e zbatimit të një projekt / program / kontratë / nënkontratë të klasifikuar.

b) Përcaktimi i standardeve, kur një person fizik ose juridik, ka aftësinë për të patur akses tek informacioni i klasifikuar dhe zotëron kapacitetet e kërkuara për administrimin e këtij informacioni, përpara se të japë një ofertë, të negociojë ose të marrë pjesë në një kontratë të klasifikuar, ose të punojë për një projekt të klasifikuar, i cili përfshin aksesin tek informacioni i klasifikuar.

Neni 2

Fusha e veprimit e kësaj rregulloreje i referohet:

a) Ministrive dhe institucioneve shtetërore (në vazhdim do t'u referohemi “Autoriteteve kontraktore”), të cilat për nevoja të realizimit të detyrave, u duhet të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me persona fizikë e juridikë, për realizimin e prokurimit të mallrave, të punëve dhe të shërbimeve, që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare dhe përbëjnë informacion të klasifikuar.

b) Personave fizikë e juridikë, (në vazhdim do t'u referohemi “Operatorëve ekonomikë/kontraktorë”), kur lidhin dhe realizojnë kontrata të klasifikuara me Autoritete Kontraktore; ose nënkontrata të klasifikuara me operatorë ekonomik të tjerë, (në vazhdim do t'u referohemi “Nënkontraktorë”).



c) Individëve, me cilësinë e konsulentit, audituesit, supervizorit, të kontraktuar nga subjektet e referuara në paragrafin “a” e “b” të këtij neni.

II. PËRKUFIZIME DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Në zbatim të kësaj rregulloreje, do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

a) “Informacion i klasifikuar” është çdo dokument a material, pavarësisht nga forma, natyra ose mënyra e transmetimit të tij, i përgatitur ose që përgatitet, për të cilin është vendosur një nivel i caktuar i klasifikimit në interes të sigurisë kombëtare dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, që kërkon mbrojtje ndaj çdo shkeljeje, shkatërrimi, përvetësimi, përhapjeje, humbjeje, ose aksesit nga ndonjë individ i paautorizuar, ose çdo lloj tjetër komprometimi sigurie.

b) “Materiali i klasifikuar” përfshin dokumentet, makineritë, pajisjet, armatimet dhe komponentët e tyre, të prodhuara ose në proces prodhimi, të klasifikuara të tilla sipas legjislacionit.

c) “Autoritet i sigurimit kombëtar” është autoriteti i brendshëm shtetëror i një shteti, përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e standardeve të sigurimit të informacionit të klasifikuar. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) është autoritet i sigurimit kombëtar në Shqipëri.

d) “Autoritet kompetent i sigurisë” është çdo autoritet i emëruar për sigurinë, ose çdo autoritet tjetër kompetent i autorizuar në pajtim me legjislacionin në fuqi të një vendi, përgjegjës për zbatimin e standardeve të sigurimit të informacionit të klasifikuar.

e) “Autoritet kontraktor” është çdo subjekt shtetëror, që merr përsipër të bëjë një prokurim të klasifikuar dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktuale.

f) “Operator ekonomik” është çdo person, fizik ose juridik, ose çdo grup personash të tillë, që ofrojnë në treg furnizimin me mallra, punime dhe/ose shërbime.

g) “Kontratë e klasifikuar” është çdo kontratë, nënkontratë, zbatim i së cilës kërkon akses tek informacioni i klasifikuar, ose përdorimin, ruajtjen, administrimin, qarkullimin, transmetimin dhe transportimin e informacionit, ose të materialit të klasifikuar.

h) “Palë kontraktore” është çdo person fizik, ose juridik, që ka zotësinë juridike për të negociuar dhe lidhur kontrata të klasifikuara.

i) “Palë dërguese” është çdo institucion publik, ose privat, që në pajtim me ligjet dhe rregullat e veta kombëtare, adreson një dërgesë të klasifikuar për palën tjetër.

j) “Palë marrëse” është çdo institucion publik, ose privat, që në pajtim me ligjet dhe rregullat e veta kombëtare, i adresohet një dërgesë e klasifikuar.

k) “Palë pritëse” është pala në territorin e së cilës zhvillohet një vizitë.

l) “Oficeri i sigurimit industrial”, më tej OSI, është punonjës i stafit menaxherial të kontraktorit, përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të sigurisë në kuadrin e një projekti / programi, kontrate/nënkontrate të klasifikuar, i cili bashkëvepron me personin përgjegjës të autoritetit kontraktor dhe autoritetin e sigurimit kombëtar.

m) “Personi përgjegjës i autoritetit kontraktor”, më tej PPAK, është punonjës i ngarkuar nga autoriteti kontraktor për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të përgjithshme të sigurisë në kuadrin e një projekti/programi/kontrate/nënkontrate të klasifikuar, i cili bashkëvepron me OSI e kontraktorit dhe autoritetin e sigurimit kombëtar.

n) “Pyetësoni i sigurimit industrial” është formulari që plotëson operatori ekonomik, mbi bazën e të cilit vlerësohen të dhënat për të lëshuar, ose jo certifikatën e sigurimit industrial.

o) “Instruksioni i sigurisë së projektit”, më tej ISP, është dokumenti që përcakton tërësinë e rregullave dhe procedurave të sigurisë, të detyrueshme, për t’u zbatuar gjatë një projekti / programi/kontrate/nënkontrate të klasifikuar.

p) “Certifikata e sigurimit industrial”, më tej CSI, është dokumenti zyrtar i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ose i një autoriteti kompetent të sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësitë organizative, teknike, fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, në një projekt/program apo kontratë/nënkontratë të klasifikuar.



q) “Nevojë për njohje” është nevoja për të pasur akses tek informacioni i klasifikuar, në kuadrin e një pozicioni të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre specifike.

r) “Vizita” është aktivitet që kryhet në kuadër të detyrimeve ndërmjet palëve në një kontratë të klasifikuar, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

s) “Vizitorë” janë përfaqësuesit zyrtarë të një pale që kërkon të vizitohet objektet dhe ambientet e palës tjetër të përfshirë në aktivitete, në lidhje me informacionin ose materialin e klasifikuar.

t) “Ofertues” është çdo operator ekonomik, që ka paraqitur një ofertë, në mbështetje të dokumentacionit të prokurimit të klasifikuar.

u) “Shkelje sigurie” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, që rezulton ose mund të rezultojë në vjedhjen, humbjen, dëmtimin, komprometimin apo përhapjen e paautorizuar të informacionit të klasifikuar.

Neni 4

Ministritë dhe institucionet shtetërore, në cilësinë e autoriteteve kontraktore, kanë detyrimin që brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik, të njoftojnë me shkrim DSIK-në, lidhur me projektet vjetore të miratuara për prokurimet e klasifikuara.

Ky njoftim duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme lidhur me objektin e prokurimeve të planifikuara dhe nivelin e klasifikimit, sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Neni 5

Operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një prokurim të klasifikuar në nivelin “TEPËR SEKRET”, “SEKRET” dhe “KONFIDENCIAL”, duhet të jenë të pajisur më parë me nivelin e kërkuar të CSI-së. Personeli që përfaqëson operatorin ekonomik në prokurimin e klasifikuar dhe individët e tjerë, që do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar, duhet të jenë të certifikuar përshtashmërisht, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në një prokurim të klasifikuar në nivelin “I KUFIZUAR”, nuk pajisen me CSI. Personeli që përfaqëson operatorin ekonomik në këtë prokurim dhe të gjithë individët që do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar “I

KUFIZUAR”, brifohen e nënshkruajnë deklaratën për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, përpara fillimit të procedurave të prokurimit të klasifikuar, sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK.

Neni 6

CSI lëshohet nga DSIK, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, për një afat deri në 4 (katër) vite.

Për operatorët ekonomikë të vendeve të tjera, CSI lëshohet nga autoritetet e sigurimit kombëtar, ose çdo autoritet kompetent sigurie i vendit, ku është i regjistruar operatori ekonomik. Kjo certifikatë konsiderohet e vlefshme në funksion të pjesëmarrjes në një prokurimin të klasifikuar, vetëm pas konfirmimit me shkrim nga DSIK, adresuar autoritetit kontraktor. DSIK-ja, përpara se të konfirmojë CSI-në, bashkëpunon me autoritetet homologe për kryerjen e verifikimeve përkatëse.

Afati i kryerjes së këtyre verifikimeve është deri në 120 ditë kalendarike.

Vetëm pas marrjes së konfirmimit nga DSIK-ja, autoriteti kontraktor i jep operatorit ekonomik të drejtën e aksesit tek informacioni i klasifikuar.

Neni 7

Mënyrat e aplikimit për t'u pajisur me CSI janë:

a) Me kërkesë të autoritetit kontraktor, për pjesëmarrje në një prokurim të klasifikuar brenda vendit;

b) Me kërkesë të autoritetit të sigurimit kombëtar të një vendi tjetër, për pjesëmarrje në një prokurim të klasifikuar, të organizuar nga autoritete kontraktore të shteteve të tjera;

c) Me kërkesë të autoritetit kompetent të sigurisë së NATO-s, të një strukture të saj, apo të një organizate tjetër ndërkombëtare, për pjesëmarrje në një prokurim të klasifikuar të organizuar prej tyre.

d) Me kërkesë të drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik vendas, kur ai plotëson kushtet e mëposhtme:

1. Gjatë tre viteve të fundit nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik nga Agjencia e Prokurimit Publik, vërtetuar me dokumentacion përkatës origjinal.



2. Zotëron qëndrueshmëri financiare të dëshmuar përmes bilanceve pozitive të tre viteve të fundit, referuar pasqyrave financiare dhe është i pajisur me licencën/at profesionale, në lidhje me veprimtarinë për të cilën do të kërkojë pajisjen me CSI (Këto dokumente duhet të jenë origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin).

3. Gjatë tri viteve të fundit ka marrë pjesë në një, ose më shumë kontrata të klasifikuara, apo të paklasifikuara, me objekt të ngjashëm me fushën e veprimtarisë për të cilën kërkon pajisjen me CSI, shoqëruar me vërtetimin/et për cilësinë e realizimit të tyre (Këto dokumente duhet të jenë origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin).

Operatorët ekonomikë, që aplikojnë për t'u pajisur me CSI për pjesëmarrje në një prokurim të klasifikuar me kërkesë të drejtpërdrejtë adresuar DSIK, kanë detyrimin që, përveç dokumenteve të kërkuara në këtë nen, të paraqesin edhe dokumentacionin e kërkuar, sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Dokumentacioni i aplikimit për t'u pajisur me CSI, përmban:

a) Kërkesën për lëshimin e CSI-së, adresuar DSIK-së, sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

b) Pyetësorin e sigurimit industrial dhe autorizimin për dhënien e pëlqimit për kryerjen e verifikimeve dhe ruajtjen e "sekretit shtetëror", sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK.

c) Ekstraktin e Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit (operatorit ekonomik).

d) Ekstraktin historik të Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit (operatorit ekonomik).

e) Dokumentin e lëshuar nga gjykata, që vërteton se në drejtim të operatorit ekonomik nuk rezulton të ketë proces penal.

f) Dokumentin e lëshuar nga prokuroria, që vërteton se ndaj operatorit ekonomik nuk është filluar ndonjë çështje penale.

g) Dokumentin e lëshuar nga zyra e përmbarimit, që vërteton se për kapitalet/asetet e operatorit ekonomik nuk ekziston një urdhër sekuestroje.

h) Dokumentin e lëshuar nga administrata tatimore, që vërteton se operatorit ekonomik i ka plotësuar detyrimet fiskale.

i) Dokumentin e lëshuar nga administrata tatimore, që vërteton se operatorit ekonomik i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore.

j) Dokumentin e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që vërteton nëse operatorit ekonomik ka kredi të marra në sistemin bankar dhe i shlyen rregullisht ato.

k) Deklaratën e pronarit /administratorit /përfaqësuesit ligjor përpara noterit, për të konfirmuar nëse operatorit ekonomik që përfaqëson, ka marrë hua dhe i shlyen rregullisht ato.

l) Faturën bankare që konfirmon kryerjen e pagesës së shërbimit për fillimin e procedurave të certifikimit:

- në shumën 50.000 lekë, për rastet e aplikimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 7, pikat "a", "b", "c";

- në shumën 100.000 lekë, për rastet e aplikimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 7, pika "d".

Dokumentet e aplikimit, sipas këtij neni, duhet të jenë origjinale, të lëshuara nga autoritetet përkatëse brenda tre muajve të fundit. Këto dokumente i adresohen DSIK-së, të shoqëruara me pyetësorët e sigurisë për verifikimin e personelit, që do të njihet me informacionin e klasifikuar.

Procedurat e verifikimit dhe afatet për lëshimin e CSI-së dhe të certifikatave të sigurisë së personelit, fillojnë në datën e pranimit të dokumentacionit të plotë nga DSIK-ja.

Neni 9

Operatorët ekonomikë, të cilët janë pajisur me CSI, janë të detyruar që të vetëdeklarojnë me shkrim brenda 15 ditëve kalendarike, çdo ndryshim të ndodhur në aspektin e pronësisë së operatorit ekonomik, aksionarëve, vendndodhjes së selisë dhe ndryshimeve në stafin menaxherial të certifikuar, përgjatë periudhës së vlefshmërisë së CSI-së.

DSIK, përpara se t'i konfirmojë një autoriteti kontraktor, ose autoriteteve homologe vlefshmërinë e CSI-së, kërkon një deklaramë me shkrim nga pronari/administratori/përfaqësuesi ligjor i operatorit ekonomik, për çdo ndryshim të ndodhur në aspektin e pronësisë së operatorit ekonomik, aksionarëve, vendndodhjes së selisë dhe ndryshimeve në stafin menaxherial të certifikuar, që nga periudha e njoftimit të pajisjes me CSI e deri në momentin e dhënë.



Ky deklaram kërkohet nga DSIK-ja, pavarësisht vetëdeklarimit të kryer, sipas përcaktimit në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 10

Procedurat e verifikimit për lëshimin e CSI-së kryhen në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe përfshijnë aspekte që lidhen me:

a) Strukturën e pronësisë së operatorit ekonomik, qëndrueshmërinë e tij financiare, reputacionin tregtar, aftësinë dhe kapacitetet teknike, si dhe aspektet e sigurisë.

b) Pronarët/aksionarët dhe stafin menaxherial, që për shkak të funksioneve do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar;

c) Personin e propozuar në pozitën e OSI-së, zëvendësit të tij dhe punonjësit, që do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar.

Neni 11

Operatori ekonomik/kontraktori, përpara se të punësojë një shtetas të huaj në një pozicion që kërkon akses tek informacioni i klasifikuar, kërkon konfirmimin e DSIK-së, nëse autoriteti homolog i vendit, shtetësinë e të cilit ky punonjës ka deklaruar, e ka pajisur atë përshtatshëmrisht me certifikatë sigurie.

Në rastet kur punonjësi i referuar në paragrafin 1 të këtij neni, ka një afat qëndrimi për një periudhë më shumë se 5 vjet në Republikën e Shqipërisë, ose ka dy shtetësi, atëherë verifikimi i tij do të kryhet nga DSIK-ja dhe autoriteti homolog i vendit tjetër.

Neni 12

DSIK ka të drejtë të kërkojë informacion nga institucionet shtetërore që e gjykon të nevojshme, për verifikimin e rrezikut të mundshëm të sigurisë së operatorit ekonomik dhe të kategorive të personave, të përcaktuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje.

Agjencitë e inteligjencës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, institucionet e drejtësisë dhe çdo strukturë shtetërore, që merr kërkesën e adresuar nga DSIK për të kryer verifikime, është e detyruar për të kthyer përgjigje dhe për të dhënë informacionin e kërkuar me shkrim, jo më vonë

se 45 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.

Informacioni i kërkuar, në funksion të procesit të verifikimit të rrezikut të mundshëm të sigurisë së operatorit ekonomik dhe të kategorive të personave të përcaktuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë i bazuar në dokumente autentike dhe dyshime të arsyeshme të mbështetura gjithmonë tek informacionet e vërtetuara.

DSIK dhe institucionet shtetërore, që marrin pjesë në kryerjen e procedurave të verifikimit për pajisjen e një operatori ekonomik me CSI-në kanë detyrimin për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të grumbulluar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Autoriteti kontraktor ka detyrimin që t'i bashkëngjisë kontratës së klasifikuar dokumentet e mëposhtme:

a) Manualin e sigurisë për projektin e kontratës.

b) Instruksionin e sigurisë së projektit.

c) Kopjet e akteve të caktimit të OSI-së, zëvendësit të tij, PPAK dhe të detyrave që ata kryejnë.

Në rastet e një kontrate të klasifikuar në nivelin "I KUFIZUAR", përveç dokumenteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", të këtij neni, bashkëngjitet edhe shtojca e Manualit të Sigurisë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 95/1 të kësaj rregulloreje.

Dokumentet e përmendura në këtë nen, në çdo rast, janë pjesë përbërëse e kontratës së klasifikuar.

Neni 14

Kontraktori është i detyruar që të propozojë për pozicionin e OSI-së dhe të zëvendësit të tij, persona që:

a) kanë shtetësinë e vendit ku është regjistruar veprimtaria e tij si operator ekonomik, ose të një vendi anëtar të NATO;

b) janë punonjës dhe pjesë e stafit menaxherial të tij;

c) kanë ose plotësojnë kushtet e sigurisë për t'u pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme dhe janë të trajnuar në disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar.

Të drejtën e miratimit ose të refuzimit për pozicionin e OSI-së dhe të zëvendësit të tij e ka DSIK-ja.



Neni 15

Transporti i dërgesës së klasifikuar kryhet duke iu përmbajtur masave të përgjithshme të sigurisë, të përcaktuara në këtë rregullore. Mbrojtja e saj do të realizohet duke iu referuar nivelit më të lartë të klasifikimit të dokumentit individual, pjesë e kësaj dërgese.

Transporti i dërgesës së klasifikuar në destinacion të përfundojë në limite sa më të shpejta kohore, për aq sa e lejojnë rrethanat konkrete.

Operatori ekonomik, që kryen transportin e dërgesave të klasifikuara “SEKRET” dhe “KONFIDENCIAL”, duhet të jetë i pajisur me CSI-në në nivelin e kërkuar, kurse punonjësit e angazhuar duhet të jenë të pajisur përshtatshëmrisht me certifikatën e sigurisë dhe certifikatën e korrierit, shoqëruar me udhëzimet për korrierin.

Kjo rregullore nuk normon procedurat e transportit të dërgesave të klasifikuara në nivelin “TEPËR SEKRET”.

Neni 16

Palët kontraktuese të programeve/projekteve /kontratave / nënkontratave të klasifikuara, brenda së cilës organizohet vizita ndërkombëtare, janë përgjegjëse për të iniciuar procedurën me DSIK-në, duke ofruar informacionet e kërkuara rreth vizitës dhe për aspektet e shkëmbimit të certifikatave të përshtatshme me autoritetin homolog të vendit tjetër, apo autoritetin kompetent të sigurisë së organizatës ndërkombëtare.

Miratimi për vizitat ndërkombëtare jepet nga DSIK-ja dhe autoriteti kompetent i sigurisë i vendit tjetër.

III. STANDARDET PËR LIDHJEN E KONTRATAVE TË KLASIFIKUARA

Neni 17

Të gjitha ftesat për ofertë të autoritetit kontraktor për një kontratë të klasifikuar, duhet të përmbajnë një dispozitë, përmes së cilës të detyrohen operatorët ekonomikë të ftuar, që nuk do të dorëzojnë një ofertë konkrete, të kthejnë tek autoriteti kontraktor, që i mundësoi ftesën për ofertë, të gjithë dokumentacionin e klasifikuar të ofertës.

Operatorët ekonomikë, të cilët kanë dorëzuar një ofertë, duhet të kthejnë tek autoriteti kontraktor, që mundësoi ftesën për ofertë, të gjithë dokumentacionin e klasifikuar të ofertës, së bashku me ofertën e tyre konkrete.

Neni 18

Autoriteti kontraktor dhe operatorët ekonomikë duhet të nënshkruajnë deklaratën për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të përfutur nga dokumentacioni i prokurimit.

Nënshkrimi i kësaj deklarate është i detyrueshëm edhe për operatorët ekonomikë, që paraqesin ofertat e tyre për lidhjen e një nënkontrate të klasifikuar me kontraktorin.

Përmbajtja dhe forma e kësaj deklarate është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Neni 19

Në procesin e negociatave për lidhjen e një kontrate/nënktrate të klasifikuar, autoriteti kontraktor merr masat që përfaqësuesi i operatorit ekonomik, i cili merr pjesë në negociatë, të ketë akses vetëm tek informacioni i klasifikuar, që ka lidhje me objektin e kontratës.

Autoriteti kontraktor mban regjistrimet e të dhënave për të gjithë pjesëmarrësit në negociatë, duke përfshirë:

- a) emrin e programit/projektit të klasifikuar;
- b) datën dhe kohën e takimit për negociatë;
- c) emrin e operatorëve ekonomikë, që kanë dorëzuar oferta dhe të dhënat e përfaqësuesve të tyre, të cilët marrin pjesë në negociatë për lidhjen e kontratës/nënktratës së klasifikuar.

Ruajtja dhe administrimi i këtyre dokumenteve bëhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Kontraktori, në çdo rast, përpara fillimit të negociatave për lidhjen e një nënkontrate të klasifikuar, duhet të marrë më parë miratimin me shkrim nga autoriteti kontraktor.

Nuk lejohet që autoriteti kontraktor të autorizojë një kontraktor me të cilin ka lidhur një kontratë të klasifikuar në nivelin “TEPËR SEKRET”, për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale në kushtet e një nënkontrate të klasifikuar.



Neni 21

Në rastin kur operatori ekonomik i përzgjedhur për të lidhur një nënkontratë të klasifikuar nuk është i pajisur me CSI-në, kontraktori, që ka kërkuar lidhjen e nënkontratës, i kërkon autoritetit kontraktor, që të paraqes kërkesën zyrtare dhe dokumentacionin përkatës tek DSIK-ja, për pajisjen me CSI-në të operatorit ekonomik.

Negociatat mes kontraktorit dhe operatorit ekonomik në funksion të lidhjes së nënkontratës zhvillohen vetëm pas pajisjes me CSI-në të operatorit ekonomik dhe në çdo rast me pjesëmarrjen dhe mbikëqyrjen e autoritetit kontraktor.

Neni 22

Autoriteti kontraktor, përpara lidhjes së kontratës së klasifikuar, kërkon nga operatori ekonomik fitues të plotësojë këto kushte të përgjithshme:

- a) Të zotërojë CSI të përshtatshme.
- b) Të ketë të pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme OSI zëvendësin e tij, si dhe të gjithë punonjësit, të cilët do kenë akses tek informacioni i klasifikuar gjatë kontratës së klasifikuar.
- c) Të ketë të brifuar për përgjegjësitë individuale të gjithë punonjësit, që do kenë akses tek informacioni i klasifikuar, gjatë kontratës së klasifikuar.

Kontrata/nënkontrata e klasifikuar përmban të gjitha shenjëzimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Çdo kontratë/nënkontratë e klasifikuar duhet që, përveç elementëve të tjera, të përmbajë edhe formulimin, sipas të cilit “mospërmbushja e standardeve të përcaktuara në ISP, përbën shkak të mjaftueshëm për zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kësaj kontrate/nënkontrate të klasifikuar”.

Neni 23

Kontratat/nënkontratat e klasifikuara nuk mund të hyjnë në fuqi përpara se të jenë përmbushur të gjitha kushtet e referuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje.

Neni 24

Autoriteti kontraktor mban regjistrimet e të dhënave për kontraktorët, me të cilët ka

nënshkruar kontrata të klasifikuara. Përmbajtja dhe forma e dokumentit të regjistrimeve është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Neni 25

Autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori, që të mbajë regjistrimet e të dhënave për nënkontraktorët, me të cilët ka lidhur nënkontratë të klasifikuar. Përmbajtja dhe forma e dokumentit të regjistrimeve për nënkontraktorët është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Neni 26

Autoriteti kontraktor/kontraktori vendos kanë detyrimin të informojnë me shkrim DSIK-në, brenda 10 ditëve, pasi kanë lidhur një kontratë/nënkontratë të klasifikuar ndërkombëtare.

Përmbajtja dhe forma e dokumentit të kërkuar në paragrafin e parë të këtij neni është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

IV. STANDARDET PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT INDUSTRIAL

Lëshimi i CSI-së

Neni 27

Operatori ekonomik, që do të pajiset me CSI, duhet që:

a) të pranojë zbatimin e masave të përcaktuara në ISP, në kuadrin e implementimit të standardeve dhe masave të veçanta për mbrojtjen e informacionit, në kushtet e një kontrate të klasifikuar;

b) pas miratimit nga DSIK-ja, të emërojë OSI dhe zëvendësin e tij, duke vënë në dispozicion të tyre burimet e nevojshme financiare për implementimin e standardeve dhe masave të sigurisë së informacionit të klasifikuar;

c) të informojë menjëherë në DSIK, të gjitha ndryshimet, referuar në nenin 31 të kësaj rregulloreje.

Neni 28

Kriteret për vlerësimin e integritetit të operatorëve ekonomikë, për lëshimin e CSI-së, bazohen në informacionet; referuar strukturës së pronësisë, suksesit, bashkëpunimit dhe aktivitetit financiar të biznesit, në raport me ekzistencën e mundshme të rreziqeve të sigurisë së informacionit, në kushtet e zbatimit të kontratës së klasifikuar.



Konsiderohen rreziqe të mundshme për sigurinë në lidhje me lëshimin e CSI-së:

a) Informacioni i paplotë ose i rremë mbi operatorin ekonomik, adresuar DSIK-së, për qëllimet e verifikimit të sigurisë;

b) Vështirësitë serioze financiare, të ardhurat e pajustificuara nga mospërputhja e kapitalit dhe pronës dhe të ardhurave të rregullta të tij;

c) Të dhënat e provuara, ose dyshime të bazuara për korrupsionin financiar ndaj zyrtarëve dhe punonjësve shtetëror, referuar nga institucionet, që marrin pjesë në kryerjen e procedurave të verifikimit.

d) Të dhëna të vërtetuara ose dyshime të bazuara për ortakëri, ose ndarje të kapitalit të huaj me origjinë të dyshimtë me kapitalin dhe pronësinë e operatorit ekonomik, referuar nga institucionet, që marrin pjesë në kryerjen e procedurave të verifikimit;

e) Të dhëna të vërtetuara ose dyshime, të bazuara nga bilanci për performancë negative të biznesit;

f) Rreziku ndaj një konflikti të mundshëm interesash në strukturën e pronësisë ndërmjet pronarëve;

g) Bashkëpunime biznesi me individë, apo operatorë ekonomikë, që kanë realizuar fitime nëpërmjet krimit të organizuar, apo veprimtarive antikushtetuese, referuar nga institucionet, që marrin pjesë në kryerjen e procedurave të verifikimit.

Neni 29

DSIK-ja merr vendim për lëshimin ose jo të CSI, bazuar në:

a) Kriteret e vendosura në nenin 28 të këtij vendimi, kur nuk ka, ose nuk janë gjetur pengesa ligjore në aspektin e sigurisë nga verifikimet e kryera për operatorin ekonomik.

b) Emërimin nga operatori ekonomik/kontraktori të OSI dhe zëvendësit të tij, pas miratimit me shkrim nga DSIK-ja.

c) Kryerjen e plotë të procedurave të verifikimit dhe brifimit të sigurisë për personat për të cilët është e nevojshme.

d) Marrjen e masave nga operatori ekonomik/kontraktori, për të zbatuar standardet e sigurimit fizik dhe rregullat për punën me informacionin e klasifikuar, në përputhje me kërkesat e legjislationit në fuqi.

e) Posedimin e mjeteve/sistemeve përshtatshëmrisht të akredituara të sigurimit të informacionit të klasifikuar nga operatori ekonomik/kontraktori.

Neni 30

Përpara lëshimit faktik të certifikatës së sigurisë për personelin e autoritetit kontraktor dhe të operatorit ekonomik/kontraktorit, PPAK, OSI e zëvendësi i tij, do të brifohen nga DSIK-ja, për të drejtat dhe detyrimet e tyre, në lidhje me masat dhe aplikimin e standardeve të sigurisë së informacionit të klasifikuar, në të gjitha disiplinat përbërëse.

Përpara marrjes së detyrës, PPAK, OSI, zëvendësi i tij, referuar në paragrafin 1 të këtij neni, nënshkruajnë në DSIK deklaratën për pranimin e përgjegjësive. Përmbajtja dhe forma e kësaj deklarate është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Me përfundimin e detyrës, PPAK, OSI, zëvendësi i tij nënshkruajnë deklaratën e debrifimit për ruajtjen e sekretit të informacionit të klasifikuar. Përmbajtja dhe forma e kësaj deklarate është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Neni 31

OSI, ose në mungesë të tij, zëvendësi, në kushtet e zbatimit të një kontrate/nëkontrate të klasifikuar, ka për detyrë që brenda 15 ditëve të informojnë DSIK mbi:

a) Ndryshimet që ndodhin në strukturën e pronësisë edhe në gjendjen financiare të kontraktorit;

b) Ndryshimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë fizike të objekteve, zyrave dhe mjediseve, ku ruhet, administrohet e përpunohet informacioni i klasifikuar;

c) Ndryshimet që kanë të bëjnë me gjendjen e sistemeve informatike të akredituara të informacionit të klasifikuar;

d) Informacione që ngrenë dyshime, në lidhje me besueshmërinë e punonjësve të autorizuar për akses në informacionin e klasifikuar;

e) Informacione për shkelje të mundshme të sigurisë, aktivitete spiunazhi, terrorizmi dhe të çdo veprimtarie antikushtetuese.



OSI mban regjistrimet e të dhënave për të gjitha shkeljet e sigurisë dhe masat e ndërmarra për korrigjimin e tyre.

Këto regjistrime vihen në dispozicion të autoritetit kontraktor dhe DSIK-së, gjatë inspektiveve të kryera prej tyre.

Me përfundimin e kontratës së klasifikuar, këto regjistrime dërgohen për ruajtje dhe administrim sipas legjislacionit në fuqi në DSIK.

Neni 32

Me kërkesë të autoritetit kompetent të sigurisë të një shteti tjetër, DSIK-ja ka të drejtë të lëshojë CSI-në në gjuhën angleze, kur nuk ekzistojnë rrethana, që paraqesin pengesa ligjore.

Forma dhe përmbajtja e CSI-së e referuar në paragrafin 1 të këtij neni, është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Neni 33

Me kërkesë të strukturës përgjegjëse të NATO-s, apo të organit të një shteti tjetër, i cili ka filluar procedurat e një prokurimi të klasifikuar për llogari të NATO-s, DSIK-ja lëshon CSI të NATO-s për operatorin ekonomik, kur nuk ekzistojnë rrethana, që përbëjnë pengesa ligjore për lëshimin e saj.

CSI e NATO lëshohet në gjuhën angleze.

Forma dhe përmbajtja e certifikatës, referuar në paragrafin 1 të këtij neni, është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK.

Angazhimi i konsulentëve, audituesve dhe supervizorëve

Neni 34

Angazhimi i konsulentëve, audituesve dhe supervizorëve për llogari dhe në interes të palëve, gjatë zbatimit të kontratës/nëkontratës së klasifikuar, është i mundur vetëm kur:

a) Ata janë të pajisur më parë me certifikatë sigurie të përshtatshme.

b) Janë të brifuar mbi procedurat e sigurisë dhe përgjegjësitë e tyre.

c) Respektojnë të njëjtat standarde e kërkesa sigurie, si punonjësit e tjerë, të përfshirë në realizimin e kontratës/nëkontratës së klasifikuar.

Ripajisja, pezullimi dhe heqja e CSI-së

Neni 35

OSI-ja ka detyrë që, përmes titullarit të kontraktorit, të njoftojë me shkrim PPAK-në, që është palë në kontratën e klasifikuar, 150 ditë kalendrike përpara se të përfundojë afati i vlefshmërisë së CSI-së të kontraktorit.

Autoriteti kontraktor përmes PPAK, fillon procedurën e ripajisjes me CSI-në për kontraktorin, kur realizimi i kontratës/nëkontratës së klasifikuar është në proces e sipër, ose në rastin e pjesëmarrjes në një tjetër kontratë/nëkontratë të klasifikuar me të njëjtin autoritet kontraktor.

Neni 36

Pas kryerjes së procedurave të riverifikimit, bazuar në ndryshimin e informacioneve, që kanë të bëjnë me kontraktorin dhe kur nuk ekzistojnë rrethana, që përbëjnë pengesa ligjore, DSIK bën ripajisjen me CSI.

Ripajisja me certifikatë sigurie për personelin e angazhuar nga kontraktori në kontratën/nëkontratën e klasifikuar, bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 37

DSIK ka të drejtë të marrë vendim për pezullimin ose heqjen e CSI në rastet kur nëpërmjet shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit merr informacione, që përbejnë rrezik për sigurinë, ose në qoftë se:

a) Kontraktori nuk i përmbush kushtet për lëshimin CSI-së, referuar në nenet 28, 29, të kësaj rregulloreje;

b) Kontraktori ka shpallur falimentimin;

c) Certifikatat e sigurisë për personelin, apo certifikata lidhur me akreditimin e sistemeve informatike të informacionit të klasifikuar, referuar në nenin 31 të kësaj rregulloreje, janë refuzuar ose hequr;

d) Kërkesa për rinovimin e CSI-së nuk është dërguar brenda afatit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

e) DSIK-ja nuk ka marrë njoftimin me shkrim brenda 15 ditëve lidhur me ndryshimet e referuara në nenin 31, pikat, “a”, “b”, “c”, “d”, “e” të kësaj rregulloreje.



DSIK-ja ka të drejtë që të vendosë për pezullimin, ose heqjen e CSI për kontraktorin/nënkontraktorin, kur vlerëson se ekzistojnë rrethanat e referuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje, të cilat përbëjnë kërcënim për sigurinë e informacionit të klasifikuar që administrohet, ose/edhe prodhohet në kushtet e një kontrate/nënkontrate të klasifikuar.

Neni 38

Njoftimi për vendimin e marrë nga DSIK-ja për pezullimin, ose heqjen e CSI-së, referuar nenit 37 të kësaj rregulloreje, i komunikohet me shkrim autoritetit kontraktor dhe nëpërmjet tij, vihet në dijeni kontraktori.

Autoriteti kontraktor, ose kontraktori, kanë të drejtë që të paraqesin kërkesë me shkrim, për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK-ja për pezullimin, ose heqjen e CSI-së, referuar nenit 37 të kësaj rregulloreje.

Kjo kërkesë i adresohet titullarit të DSIK-së brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit për vendimin për pezullimin, ose heqjen e CSI-së, referuar nenit 37 të kësaj rregulloreje.

Titullari i DSIK shqyrton dhe vendos mbi kërkesën e referuar në paragrafin 2 të këtij neni, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të kërkesës në institucion.

Në rastet e mospajtimit me përgjigjen e titullarit të DSIK-së, brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit, autoriteti kontraktor, ose kontraktori, kanë të drejtë që t'ia adresojnë ankesën e tyre me shkrim Kryeministrit.

Kryeministri, pas marrjes së ankesës, brenda 30 ditëve kalendarike, shprehet me akt të veçantë, i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga DSIK-ja, autoriteti kontraktor dhe kontraktori.

Neni 39

Vendimi mbi pezullimin e CSI-së është i vlefshëm deri në momentin e shuarjes së rrethanave, që përbëjnë rrezik të mundshëm sigurie, ose deri në momentin kur CSI-së i ka kaluar afati i vlefshmërisë.

Neni 40

Në rastet kur DSIK-ja pezullon, ose heq CSI-në, duhet të informojë menjëherë të gjitha palët e përfshira në realizimin e kontratës së klasifikuar.

Për rastet kur kontraktori/nënkontraktori është palë në një kontratë/nënkontratë të klasifikuar ndërkombëtare, DSIK-ja njofton menjëherë autoritetin kompetent të sigurisë.

Neni 41

Me përfundimin e kontratës së klasifikuar, kontraktori/nënkontraktori ka për detyrë që:

a) Të kthejë menjëherë tek autoriteti kontraktor të gjitha informacionet e klasifikuara, të përfuara në kushtet e zbatimit të kontratës së klasifikuar.

b) Të udhëzojë personelin që u përfshi në realizimin e kontratës/nënkontratës së klasifikuar, për rregullat e ruajtjes dhe të mospërhapjes së informacionit të klasifikuar, duke nënshkruar individualisht deklaratën e debrifimit, sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Pajisja me certifikatë sigurie e punonjësve të operatorit ekonomik/kontraktorit

Neni 42

Procedura e lëshimit të certifikatës së sigurisë për punonjësit e operatorit ekonomik/kontraktorit, që do të përfshihen në një kontratë/nënkontratë të klasifikuar, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 43

DSIK-ja ka të drejtë që, për shkaqe sigurie, të pezullojë përkohësisht, ose t'i heqë certifikatën e sigurisë një qytetari shqiptar, i cili është punësuar pranë një operatori ekonomik/kontraktori të një shteti tjetër. Në këtë rast, DSIK-ja njofton menjëherë autoritetin kompetent të sigurisë së shtetit tjetër.

Pezullimi ose/dhe heqja e certifikatës së sigurisë, referuar paragrafit të parë të këtij neni, bëhet mbështetur në dokumente autentike dhe dyshime të arsyeshme, bazuar tek informacionet e vërtetuara zyrtare.

Neni 44

Çdo punonjës i një kontraktori/nënkontraktori i pajisur me certifikatë sigurie, është i detyruar menjëherë të raportojë tek OSI-ja, për të gjitha ndryshimet lidhur me informacionin dhe përgjigjet e dhëna në pyetësin personal të sigurisë.

OSI informon menjëherë drejtuesin e kontraktorit dhe PPAK lidhur me ndryshimet e

informacionit, referuar ne paragrafin 1 të këtij neni, kurse PPAK njofton me shkrim DSIK për këto ndryshime.

Neni 45

OSI-ja merr masat për ruajtjen dhe administrimin e regjistrimeve për të gjithë personat e certifikuar në funksion të një projekti, programi, kontrate/nënkontrate të klasifikuar, lidhur me datën e lëshimit të certifikatës së sigurisë, nivelin dhe afatet e vlefshmërisë.

OSI-ja, bazuar në regjistrimet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, informon mbajtësin e certifikatës së sigurisë dhe drejtuesin e kontraktorit, 120 ditë kalendarike, përpara datës së skadimit të vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë.

Kur drejtuesi i kontraktorit vendos që punonjësi të vazhdojë të punojë në një pozicion, që kërkon akses tek informacioni i klasifikuar, OSI-ja e udhëzon punonjësin për të kryer riaplikimin për t'u pajisur me certifikatë sigurie.

OSI-ja e adreson dokumentacionin e riaplikimit tek PPAK-ja dhe përmes tij në DSIK, për të vijuar procedurat e mëtejshme.

V. KUSHTET E SIGURISË PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË KLASIFIKUAR

Manuali i Sigurisë dhe lista e dokumenteve të klasifikuara të autoritetit kontraktor

Neni 46

Procesi i klasifikimit në lidhje me një projekt, ose program konkret, bazohet tek lista e dokumenteve të klasifikuara e autoritetit kontraktor, miratuar sipas legjislacionit në fuqi.

Autoriteti kontraktor, mbështetur në përcaktimet e kësaj liste, koncepton në çdo rast manualin e sigurisë, në të cilin përshkruhen udhëzimet specifike, që duhen ndjekur për një prokurim të klasifikuar dhe formalizmin e kontratës së klasifikuar në përputhje me specifikat e saj.

Neni 47

Autoriteti kontraktor është struktura përgjegjëse për hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e kërkesave të Manualit të Sigurisë.

Dispozitat e Manualit të Sigurisë, referuar në paragrafin 1 të këtij neni, mund të pasurohen e ndryshohen gjatë realizimit të kontratës së klasifikuar nga autoriteti kontraktor.

Instrukcioni i sigurisë së projektit (ISP)

Neni 48

ISP paraqet tërësinë e masave të detyrueshme, që do të aplikohen nga kontraktori për zbatimin e standardeve të sigurimit të informacionit gjatë kontratës së klasifikuar.

ISP hartohet në përputhje me objektin e kontratës së klasifikuar dhe masat për sigurimin e informacionit të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument përgatitet nga autoriteti kontraktor dhe miratohet nga DSIK-ja dhe në çdo rast është pjesë integrale e kontratës së klasifikuar.

Për kontratat e klasifikuara ndërkombëtare, ISP bëhet në gjuhën angleze dhe miratohet sipas rastit nga autoriteti kompetent i sigurisë.

Kontraktuesi ka detyrimin që të mbajë lidhje të vazhdueshme me autoritetin kontraktor dhe autoritetin kompetent të sigurisë, për aplikimin rigoroz të standardeve të përcaktuara në ISP.

Neni 49

Në kuadrin e masave të parashikuara në ISP, kontraktuesi ka për detyrë që:

a) Të mos riprodhojë informacionin e klasifikuar të siguruar, ose të gjeneruar gjatë kontratës, me përjashtim të rasteve kur lejohet nga kushtet e kontratës, ose pas miratimit të dhënë nga autoriteti kontraktor;

b) Të përcaktojë punonjësit që do të njihen me informacion të klasifikuar në bazë të nevojës për njohje dhe të mos lejojë që punonjës të papajisur përshtatshëmrisht me certifikatë sigurie dhe të paautorizuar, të kenë mundësi të njihen me këto kategori informacionesh;

c) Të mbajë e të administrojë të dhëna të nevojshme rreth punonjësve të certifikuar për njohje me informacionin e klasifikuar, në funksion të kontratës/nënkontratës së klasifikuar;

d) Të raportojë çdo thyerje, që cenon sigurinë e informacionit të klasifikuar, apo ngre dyshime mbi besueshmërinë, besnikërinë dhe sigurinë e një punonjësi, që ka akses tek informacioni i klasifikuar;

e) Të vendosë çdo nënkontraktues nën detyrime sigurie jo më të ulëta se ato të parashikuara në kontratën e klasifikuar dhe të aplikuara nga kontraktuesi;

f) Të mos përdorë informacionin e klasifikuar të gjeneruar në kushtet e kontratës, pa autorizim të



veçantë me shkrim të autoritetit kontraktor dhe jashtë qëllimeve specifike të kontratës/nënkontratës;

g) T'i kthejë autoritetit kontraktor, ose kontraktuesit (për rastin e nënkontraktuesit), të gjithë informacionin e klasifikuar, përveç rasteve kur me autorizimin me shkrim nga autoriteti kontraktor është përcaktuar ndryshe.

Kthimi i këtij informacionit bëhet sipas specifikimeve të autoritetit kontraktor.

Lidhja e kontratave të klasifikuara me një konsorcium⁷

Neni 50

Gjatë lidhjes së kontratave të klasifikuara me operatorë ekonomikë të bashkuar në një konsorcium, kërkohet zbatimi i masave të sigurisë, si më poshtë:

a) Konsorciumi, si palë kontraktuese, gjatë lidhjes së një kontrate të klasifikuar me një autoritet kontraktor, ka të njëjtin status, si çdo kontraktor tjetër.

b) Autoriteti kompetent i sigurisë i vendit, ku konsorciumi është i regjistruar, lëshon CSI. Për filiale, apo degë të konsorciumit që operojnë në vende të ndryshme, CSI lëshohet nga autoritetet kompetente të sigurisë së shteteve, ku janë të regjistruara dhe operojnë filialet, apo degët e konsorciumit;

c) Certifikata e sigurisë për punonjësit e konsorciumit lëshohet nga autoriteti kompetent i sigurisë i vendit, shtetësinë e të cilit ato mbajnë.

d) Filialet, apo degët e konsorciumit, që marrin pjesë në një program/projekt të klasifikuar ndërkombëtar, respektojnë dispozitat e vendosura në ISP.

VI. STANDARTET E SIGURISË GJATË TRANSPORTIT

Rregulla të përgjithshme

Neni 51

Transporti kombëtar dhe ndërkombëtar i materialit të klasifikuar në nivel "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe standardet e

⁷ Është një shoqëri, ortakëri apo bashkim i dy a më shumë operatorëve ekonomik, ose bashkim i burimeve të tyre me qëllim pjesëmarrjen në një aktivitet për arritjen e një qëllimi të përbashkët.

sigurisë, sipas kushteve të kontratës/nënkontratës së klasifikuar.

Neni 52

Plani i transportit të dërgesës së klasifikuar propozohet nga pala kontraktuese, e cila porositi transportin.

Pala dërguese dhe pala marrëse miratojnë planin e transportit të dërgesës së klasifikuar dhe përmbushin të gjitha kërkesat e sigurisë, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Planet e transportit bëhen për secilën dërgesë dhe duhet të përmbajnë masat për parandalimin e aksesit të paautorizuar tek informacioni i klasifikuar.

Neni 53

Plani i transportit ndërkombëtar të materialit të klasifikuar përmban përmbajtjen e ngarkesës së klasifikuar, personat kompetentë për transportin e materialit të klasifikuar, mjetet e transportit, informacionin mbi korrierin, ose agjentin komercial për transportin e materialit të klasifikuar dhe itinerarin e transportit.

Plani i transportit ndërkombëtar, referuar në paragrafin 1 të këtij neni, miratohet nga DSIK dhe autoriteti kompetent i sigurisë i vendit tjetër, që është palë në transport.

Neni 54

DSIK-ja informon autoritetin kompetent të sigurisë të secilit vend, përmes të cilit do të kalojë ngarkesa e klasifikuar, mbi detajet e transportit, në mënyrë të tillë që paraprakisht të sigurohet mbështetja e nevojshme.

Për rastet e anulimeve të transportit ndërkombëtar, DSIK-ja informon në kohë të gjitha vendet e njoftuara më parë.

Dogana

Neni 55

DSIK-ja informon me shkrim strukturën doganore përgjegjëse për mbërritjen e ngarkesës së klasifikuar.

Doganierët, ose punonjësit e policisë, të cilët do të kenë akses te dokumentacioni shoqërues i ngarkesës së klasifikuar, nënshkruajnë dhe konfirmojnë njohjen e tyre me ngarkesën e klasifikuar.



Në çdo rast, këta punonjës duhet të jenë të pajisur më parë me certifikatë sigurie të përshtatshme.

Në asnjë rrethanë, ngarkesa e klasifikuar nuk duhet të dorëzohet për ta lënë në ruajtje te doganierët, ose zyrtarët e tjerë shtetërorë, pavarësisht funksionit dhe detyrave që kryejnë.

Dokumentet e transportit

Neni 56

Dokumentet e transportit janë pjesë përbërëse e ngarkesës së klasifikuar dhe nuk duhet që, në asnjë rrethanë, të ekspozohen si të tilla ndaj personave të paautorizuar. Ato përbëhen nga i gjithë dokumentacioni shoqëruar i ngarkesës së klasifikuar, me të dhënat për destinacionin përfundimtar të ngarkesës, parashikimin për datën, kohën e mbërritjes, pajisjet për dorëzim, gjeneralitetet dhe të dhënat identifikuese për pozicionin e personit të palës marrëse të ngarkesës.

Pala marrëse, përmes personit të autorizuar, konfirmon pranimin e ngarkesës së klasifikuar, duke nënshkruar dokumentacionin përkatës të transportit.

Paketimi

Neni 57

Paketimi i ngarkesës së klasifikuar kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

OSI i palës dërguese është përgjegjës për kontrollin e paketimit të ngarkesës së klasifikuar.

Shenjëzimi mbi paketim nuk duhet të tregojë se kemi të bëjmë me ngarkesë të klasifikuar.

Standardet e sigurisë për të gjitha mënyrat e transportit

Neni 58

Për të gjitha mënyrat e transportit zbatohen standardet e detyrueshme të sigurisë, si më poshtë:

a) Merren masat për sigurimin e dërgesës së klasifikuar, në të gjitha fazat dhe rrethanat e transportit, nga origjina deri në destinacionin e fundit;

b) Niveli i klasifikimit i dërgesës së klasifikuar duhet të jetë i njëjtë, ose në nivelin më të lartë të informacionit të klasifikuar, që ka përmbajtja brenda saj;

c) Operatori ekonomik, të cilit do t'i besohet transporti i materialit të klasifikuar, duhet të ketë CSI-në, në nivelin më të lartë të klasifikimit të materialit, që do të transportojë.

d) Personeli, që do të angazhohet për transportin e materialit të klasifikuar, duhet të jetë i pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme;

e) Rrugët për transportimin e materialit të klasifikuar, duhet të organizohen përmes vendeve anëtare të NATO, ose vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar.

Transporti dorazi i materialit të klasifikuar

Neni 59

Transporti dorazi i materialit të klasifikuar kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, për transportin fizik të informacionit të klasifikuar.

Neni 60

Për transportin dorazi të materialit të klasifikuar në nivelin “SEKRET” dhe “KONFIDENCIAL”, të zbatohen edhe standardet shtesë të sigurisë, si më poshtë:

a) Korrieri duhet të jetë punonjës i përhershëm i organikës së palës dërguese ose palës marrëse.

b) Agjentët e transportit, ose shërbimet komerciale ndërlidhëse, nuk do të përdoren për transportin dorazi;

c) Korrieri duhet të jetë i pajisur me certifikatë korrieri, të nënshkruar dhe të vulosur nga autoriteti kompetent i sigurisë. OSI i palës dërguese, i jep atij autorizim për transportin.

d) Për transportin ndërkombëtar të materialit të klasifikuar, korrieri pajiset me certifikatën e korrierit në gjuhën angleze. Përmbajtja dhe forma e kësaj certifikate është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

e) DSIK-ja, për raste të veçanta, mundet që me autorizim paraprak nga autoriteti kompetent i sigurisë së vendit të palës marrëse, të gjykojë lëshimin e certifikatës së korrierit për një person me shtetësi tjetër, nëse ai/ajo ka certifikatë sigurie të përshtatshme, si dhe nëse vendi i tij/saj e autorizon për dorëzimin e materialit të klasifikuar.

f) Pasi dërgesa e klasifikuar është dorëzuar në destinacionin e përcaktuar, korrieri e kthen certifikatën e korrierit tek OSI i palës dërguese. Korrieri paraqet me shkrim të gjitha detajet e rrugëtimit, që mund të jenë të rëndësishme për sigurinë e dërgesës së klasifikuar. Certifikata e korrierit ruhet 5 (pesë) vite dhe pas këtij afati shkatërrohet.



g) Procedura e transportit përcaktohet rast pas rasti, me autorizim paraprak nga DSIK-ja dhe autoritetet kompetente të sigurisë së vendeve, që kanë lidhje me transportin e materialit të klasifikuar.

h) DSIK-ja lëshon certifikatën e korrierit për transportin dorazi të materialit të klasifikuar në nivelin "I KUFIZUAR".

Neni 61

OSI udhëzon dhe instrukton punonjësit e ngarkuar për të gjitha procedurat dhe masat e sigurisë, që do të aplikohen gjatë transportit të materialit të klasifikuar dhe përgjegjësitë përkatëse.

Punonjësit e ngarkuar për transportin e materialit të klasifikuar nënshkruajnë dhe konfirmojnë se janë njohur me "Udhëzimet për korrierin" dhe se janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre.

Neni 62

Autoriteti kompetent i sigurisë i vendit, ku gjatë transportit të materialit të klasifikuar, ka dyshime, ose ka ndodhur një shkelje sigurie, duhet të informojë në kohë palën dërguese dhe të iniciojë veprime, sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar rrethanat e shkeljes.

Palës dërguese i adresohet një raport mbi masat e marra dhe procedurat e ndjekura, për të parandaluar përsëritjen e shkeljes.

Në rast se shkeljet e sigurisë ndodhin në një vend të tretë, autoriteti kompetent i palës dërguese, kur është e mundur, do të ndërmarrë veprimet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Transporti i materialit të klasifikuar nga transportues komercial

Neni 63

Transporti i materialit të klasifikuar "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", lejohet të kryhet nga transportues komercial, kur për shkak të madhësisë së materialit të klasifikuar, transporti i tij nuk mund të organizohet në kushte të tjera.

Neni 64

Për transportimin e ngarkesave të klasifikuara në nivel "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", transportuesit komercial duhet të plotësojnë kërkesat e sigurisë, si më poshtë:

a) Të jenë të pajisur më parë me CSI të përshtatshme;

b) Të jenë të regjistruar dhe të autorizuar për të ofruar shërbime ndërkombëtare transporti;

c) Të përmbushin të gjitha masat e përcaktuara për sigurinë dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 65

Në rastet kur plani i transportit përfshin më shumë se një dërgesë ndërkombëtare të klasifikuar, procedurat për dorëzimin do të përcaktohen për secilën dërgesë, në mënyrë që pala marrëse, për çdo rast dërgese, të përftojë të dhënat e detajuara nga personeli i transportit dhe personeli i sigurisë i palës dërguese.

Procedurat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të deklarohen në njoftimin për dërgesën e klasifikuar, e cila lëshohet në anglisht.

Forma dhe përmbajtja e njoftimit të referuar në paragrafin 2 të këtij neni, është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

Neni 66

Dërgesat e klasifikuara kryhen bazuar në marrëveshjen paraprake zyrtare ndërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë, që përfaqësojnë, reciprokisht, palën marrëse dhe palën dërguese.

Transporti tokësor

Neni 67

Gjatë transportit në rrugë tokësore të materialit të klasifikuar "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", zbatohen standardet e sigurisë, si më poshtë:

a) Materiali i klasifikuar transportohet me automjete, që kanë kontenier të mbyllur me çelës, ose me dryna, sipas kërkesave të përcaktuara. Në rast se nuk është e mundur, ngarkesa duhet të ambalazhohet në një kuti dhe të mbulohet, në mënyrë që të mbrohet konfidencialiteti dhe të parandalohet aksesimi për individët e paautorizuar;

b) Për transportin e dërgesës së klasifikuar në nivelin "SEKRET", duhen dy shoferë të certifikuar përshtatshëm, ndërsa për transportimin e ngarkesës së klasifikuar në nivelin "KONFIDENCIAL", kërkohet vetëm një shofer, i cili është i pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme.



c) Ndalimi për nevoja të ndryshme i automjetit, që kryen transportin rrugor të materialit të klasifikuar, bëhet vetëm në vendqëndrime të autorizuar, brenda ambienteve në ruajtje e kontroll të rreptë, të secilit shtet të angazhuar, ose tek kontraktorë të certifikuar përshtatshmërisht.

d) Në rastet e aksidenteve, ose avarive teknike të automjetit, roja i sigurisë është përgjegjës për marrjen nën mbrojtje të vazhdueshme dhe ruajtjen e ngarkesës së klasifikuar gjatë gjithë periudhës, deri në kthimin në normalitet.

e) Automjetet, që përdoren për transport rrugor të materialit të klasifikuar, pajisen me GPS dhe sistem elektronik të miratuar, për të identifikuar në çdo moment vendndodhjen e tyre dhe për të siguruar komunikimin e pandërprerë me rojet e sigurisë dhe personelin përgjegjës të dërgesës së klasifikuar.

Transporti hekurudhor

Neni 68

Lejohet transporti hekurudhor i materialit të klasifikuar "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", vetëm kur roja i sigurisë qëndron në ruajtje të dërgesës, gjatë gjithë kohës së udhëtimit, përfshirë edhe ndalesat.

Neni 69

Për të garantuar nivelin maksimal të sigurisë së materialit të klasifikuar, që transportohet në rrugë hekurudhore, në varësi të vëllimit e madhësisë së dërgesës, prioritetet u jepet vagonëve, ose kontenierëve, që janë të izoluar dhe të mbyllur.

Transporti detar

Neni 70

Materiali i klasifikuar "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL" transportohet në rrugë detare, duke zbatuar standardet e sigurisë, si më poshtë:

a) Dërgesa e klasifikuar transportohet me mjete lundruese, nën flamurin e një vendi anëtar të NATO-s, ose të një vendi me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshje për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar.

b) Kapitani i anijes që përdoret për transportin e ngarkesës së klasifikuar, në nivelin "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", duhet të jetë i certifikuar përshtatshmërisht.

Ai duhet të jetë shtetas i një vendi anëtar të NATOS, ose shtetas i një vendi me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar.

Në qoftë se kjo nuk është e mundur, ngarkesa duhet të sigurohet nga roje sigurie, ose eskortë speciale e certifikuar përshtatshmërisht.

c) Materiali i klasifikuar duhet të vendoset në një kontenier të mbyllur dhe të sigurve. Kur kjo nuk është e mundur, vendosja e dërgesës së klasifikuar të bëhet në një zonë të hapur brenda mjetit lundrues, e cila duhet të jetë e miratuar më parë.

Kjo zonë duhet të jetë e rrethuar dhe e mbrojtur nga ngarkesa të tjera me destinacion mbërritje të njëjtë me dërgesën e klasifikuar dhe në mënyrë të tillë, që në vlerësimin e rojeve të sigurisë, aksesit tek dërgesa e klasifikuar, të rezultojë fizikisht i pamundur.

Në çdo rast dhe gjatë gjithë kohës, ngarkesa duhet të jetë nën kontroll e mbikëqyrje të vazhdueshme të rojës së sigurisë, ose eskortës speciale të certifikuar përshtatshmërisht.

d) Ndalesat në vendet që paraqesin rrezik të veçantë sigurie, bëhen vetëm pasi më parë janë marrë autorizimet përkatëse, nga autoriteti kompetent i sigurisë së palëve, si dhe janë përfshirë e specifikuar në planin e transportit, të miratuar nga strukturat përgjegjëse, duke marrë në konsideratë situatën politike.

Mjeti lundrues mund të hyjë në ujërat territoriale të vendeve të tilla vetëm në rastet e emergjencës.

e) Nuk lejohet ndalesa në portin e një vendi, që nuk është anëtar i NATO-s, ose vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë nuk ka nënshkruar Marrëveshjen për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur është marrë autorizim paraprak nga autoriteti kompetent i sigurisë.

f) Në çdo rast, ngarkim-shkarkimi i materialit të klasifikuar duhet të jetë nën kontroll dhe mbikëqyrje të vazhdueshme sigurie.

g) Sigurimi i dërgesave të klasifikuara dhe grumbullimi i tyre në depot e portit përpara imbakimit, kryhet duke angazhuar një numër të mjaftueshëm të rojeve të sigurisë për ruajtje dhe mbikëqyrje, nëse nuk është marrë përsipër siguria nga një strukturë e sigurve dhe certifikuar përshtatshmërisht nga autoriteti kompetent i sigurisë i vendit të palës dërguese.



Neni 71

Kur dërgesa përmban material të klasifikuar në nivelin "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", detyrat e rojeve të sigurisë mund të merren përsipër nga kapiteni i anijes, ose anëtarët e ekuipazhit të autorizuar, kur ato janë të pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme.

Transporti ajror

Neni 72

Për transportin ajror të materialit të klasifikuar në nivelin "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", përparësi do t'u jepet përdorimit të avionëve ushtarakë shqiptarë, të vendeve të NATO-s ose të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshjen për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar.

Neni 73

Për transportin ajror të materialit të klasifikuar "SEKRET" dhe "KONFIDENCIAL", zbatohen standardet e sigurisë, si më poshtë:

a) Dërgesa e klasifikuar dorëzohet direkt në avion. Kur ajo nuk mund të dorëzohet menjëherë, do të kthehet ose të ruhet në mjedise të miratuara nga autoriteti kompetent i sigurisë.

Gjatë marrjes në ruajtje aktivizohen një numër i mjaftueshëm i rojeve të sigurisë, për të garantuar mbikëqyrjen e pandërprerë të dërgesës.

b) Me të mbërritur, dërgesa e klasifikuar merret në zotërim menjëherë nga personat e autorizuar. Kur kjo nuk është e mundur, dërgesa mund të mbahet në aeroport, por vetëm nëse ka një numër të mjaftueshëm të rojeve të sigurisë, përgjegjëse për mbikëqyrjen e pandërprerë të kësaj dërgese.

c) Ndalesat afatshkurtra mund të lejohen, me kusht që dërgesa të qëndrojë në avion. Në rastet kur dhoma e ngarkesave hapet, korrieri, ose personeli i certifikuar, duhet të garantojnë sigurinë dhe mbrojtjen e saj.

d) Në rast se avioni vonohet për një periudhë më të gjatë, ose i është dashur të bëjë një ulje emergjente, roja i sigurisë, ose personi që kryen detyrat e rojës së sigurisë, duhet të marrë të gjitha masat që konsiderohen të domosdoshme për mbrojtjen e dërgesës së klasifikuar.

Në rast se ndalesa është bërë në një vend të NATO-s, ose në një vend me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshjen për

mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, roja i sigurisë ka të drejtë të kërkojë ndihmë nga autoriteti kompetent i sigurisë së atij vendi.

e) Ndalesat brenda vendeve, të cilat përbëjnë një rrezik serioz sigurie, duhet të jenë të autorizuar nga autoritetet kompetente të sigurisë, që në fazën e miratimit të planit të transportit.

f) Kur është e mundur, për transportin e ngarkesave të klasifikuara, të përdoren fluturimet direkte.

g) Nuk lejohen ndalesat në aeroporte dhe aerodrome të vogla të vendeve, që nuk janë anëtare të NATO-s, ose në vendet me të cilat Republika e Shqipërisë nuk ka nënshkruar Marrëveshjen për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, me përjashtim të rasteve të emergjencës.

Neni 74

Rojat e sigurisë, që marrin pjesë në transportin e një dërgese të klasifikuar, janë personel civil ose ushtarak. Ato mund të jenë të armatosur në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e autoriteteve kompetente të sigurisë.

Rojat e sigurisë duhet të jenë shtetas të vendeve të NATO-s, ose vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshjen për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, si dhe të pajisur më parë me certifikatë sigurie të përshtatshme.

Neni 75

Përveç rojave të sigurisë, mund të aktivizohen edhe eskortat e sigurisë, me kusht që autoritetet kompetente të sigurisë së palëve, të kenë dhënë më parë pëlqimin e tyre.

Për punonjësit e eskortës të sigurisë nuk është e nevojshme pajisja me certifikatë sigurie.

Neni 76

Numri i rojave të sigurisë dhe eskortave, për çdo ngarkesë të klasifikuar, varet nga niveli i klasifikimit të sigurisë së dërgesës, mënyra e transportit, vlerësimi i kohës që duhet për transit, si dhe sasia e materialit të klasifikuar.

Numri i mjaftueshëm i rojave të sigurisë dhe eskortave duhet të garantojë kryerjen e rregullt të detyrës dhe mbajtjen e personelit rezervë, për ndërhyrje në rastet e emergjencave.



Neni 77

Autoriteti kontraktor duhet të pajisë rojet e sigurisë me autorizimin përkatës, për rastet e transportit ndërkombëtar të dërgesave të klasifikuara. Autorizimi me shkrim për rojat e sigurisë bëhet në gjuhën angleze.

Forma dhe përmbajtja e këtij autorizimi është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK -ja.

Neni 78

OSI i palës dërguese informon e brifon rojat e sigurisë për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, për planin e transportit dhe për masat e tjera, që do të merren në rast emergjence.

Rojat sigurisë njihen dhe nënshkruajnë kopjen e “Udhëzimeve të korrierit”.

Neni 79

Kopje të autorizimit për rojat e sigurisë mund të përgatiten edhe në gjuhë të tjera, si një shtojcë e kopjes në gjuhën angleze, nëse kjo gjykohet e nevojshme, apo në rast se kërkohet nga autoritetet kompetente të sigurisë të palëve.

Transportimi i lëndëve plasëse apo substancave të tjera të rrezikshme

Neni 80

Pala dërguese e ngarkesës së klasifikuar që përmban eksploziv, ose substanca të tjera të rrezikshme, është e detyruar të zbatojë të gjitha rregullat e përcaktuara të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare për këtë çështje.

VII. STANDARDET E SIGURISË SË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR GJATË VIZITAVE NDËRKOMBËTARE

Dispozita të përgjithshme

Neni 81

Vizitat ndërkombëtare realizohen nga përfaqësues civilë, ushtarakë dhe kontraktorë/nënkontraktorë të vendeve të NATO-s, ose vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshjen për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar.

Punonjësit e palëve, që kanë të nevojshme kryerjen e një vizite ndërkombëtare, lidhur me realizimin e një programi, projekti, kontrate/nënkontrate të klasifikuar, që kërkon akses tek

informacioni i klasifikuar, duhet që më parë të plotësojnë kërkesën për vizitë në gjuhën angleze.

Kur vizita ndërkombëtare i përket palëve të një kontrate të klasifikuar në Republikën e Shqipërisë, autoriteti kompetent i sigurisë i vendit të origjinës së vizitorit i adreson DSIK-s kërkesën për vizitë.

Forma dhe përmbajtja e kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij neni, është sipas modelit të përcaktuar e miratuar nga DSIK-ja.

DSIK-ja e autorizon kryerjen e vizitës sipas kërkesës, në qoftë se në formatin e saj është konfirmuar se vizitori është i pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme.

Neni 82

Llojet e vizitave, që mund të kryhen në kuadrin e një programi, projekti, kontrate/nënkontrate të klasifikuar, janë:

a) Vizita njëherëshe ka qëllim specifik, zgjat deri në 30 ditë dhe nuk përsëritet brenda vitit.

b) Vizitat periodike përsëriten gjatë një periudhe të caktuar në intervale kohore dhe nuk zgjasin më shumë se një vit.

c) Vizita emergjente është vizitë njëherëshe, që aplikohet vetëm në ndonjë rast urgjence me rëndësi të veçantë dhe në kushtet e pamundësisë për aplikimin e procedurave standarde të kërkesës për vizitë.

Neni 83

Palët në një kontratë të klasifikuar, që kanë nevojë të dërgojnë punonjësit e tyre në një vizitë njëherëshe, apo në vizita periodike, janë të detyruara që përmes autoritetit kompetent të sigurisë, të plotësojnë e dërgojnë kërkesën për vizitë, adresuar palës pritëse.

Neni 84

Kërkesat për vizita ndërkombëtare duhet të dërgohen në përputhje me afatet e përcaktuara, në varësi të kërkesave të vendeve të veçanta dhe të organizatave ndërkombëtare.

Autoriteti kompetent i sigurisë i vendit pritës informohet në kohë për të gjitha ndryshimet e datave ose anulimeve të vizitës.

Njoftimi i këtyre ndryshimeve jashtë afateve të përcaktuara është i pavlefshëm dhe nuk merret në konsideratë.

Datat e vizitave emergjente nuk ndryshohen.



Neni 85

Pala që do të vizitohet, përpara se të autorizojë aksesin tek informacioni i klasifikuar, duhet të ketë konfirmuar se:

- a) Vizita ka qëllim zyrtar, që lidhet me një program/projekt/kontratë të klasifikuar;
- b) Çdo vizitor është i pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme dhe ka ofruar informacionin e nevojshëm për identifikim;
- c) DSIK e ka autorizuar kryerjen e vizitës;
- d) Niveli i klasifikimit të sigurisë i paraqitur në kërkesën për vizitë, është i njëjtë me nevojat e vizitës.

Neni 86

Kërkesa për vizitat periodike dorëzohet një herë në vit dhe është e vlefshme 12 muaj nga data e lëshimit të saj.

Neni 87

Në të gjitha rastet, vizita njëherëshe quhet e miratuar e mund të kryhet nëse autoriteti kompetent i sigurisë i palës pritëse nuk kryen një njoftim ndryshe, të paktën tre ditë pune në avancë nga data e fillimit të kësaj vizite.

Neni 88

Detajet e vizitave në kushtet e një programi, projekti, kontrate/nëkontrate të klasifikuar në nivelin "I KUFIZUAR", vendosen në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërmjet palëve kontraktore, me miratimin e PPAK-së dhe të OSI-së.

Vizita e emergjencës

Neni 89

Vizita e emergjencës mund të kryhet vetëm në rrethana të veçanta, kur procedurat standarde për vizitën njëherëshe ose periodike nuk mund të zbatohen.

Vizita e emergjencës duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- a) Vizita e propozuar është e lidhur me një program, projekt, kontrate/nëkontrate të klasifikuar.
- b) Vizita është autorizuar mbi bazën e ftesës zyrtare të vendit pritës.
- c) Kërkesa për vizitë aprovohet pasi refuzimi i saj do të mund të komprometonte përmbushjen e një programi, projekti, kontrate/nëkontrate të klasifikuar.

Neni 90

OSI kryen vlerësimin përkatës, duke shqyrtuar në mënyrë të detajuar kërkesën dhe dokumentacionin, që justifikon nevojën e vizitës së emergjencës.

OSI, kur gjen se janë përmbushur kushtet e referuara në nenin 89 të kësaj rregulloreje, njofton dhe merr miratimin verbal tek personi përgjegjës i autoritetit kontraktor, që do të vizitohet, për organizimin e vizitës së propozuar.

Miratimi verbal duhet të bëhet jo më pak se tre ditë pune përpara kryerjes së vizitës.

Pas miratimit verbal të kërkesës për vizitën e emergjencës, autoriteti kontraktor që do të vizitohet, duhet të informojë menjëherë, me shkrim, autoritetin kompetent të sigurisë mbi marrjen e konfirmimit të kërkesës për vizitën e emergjencës dhe të sqarojë arsyet e kësaj emergjence.

Neni 91

OSI i palës kërkuese, bazuar në miratimin verbal, adreson njoftimin për vizitën e emergjencës në formën e kërkesës për vizitë në gjuhën angleze, me këto specifikime:

- a) Njoftimi duhet të etiketohet si prioritet dhe të dërgohet tek autoriteti kompetent i sigurisë i vendit që do të vizitohet, brenda 24 orëve nga marrëveshja verbale për vizitën e emergjencës.
- b) Njoftimi duhet të përmbajë etiketimin e emergjencës (emrin e programit, projektit, kontratës ose kërkesës për propozim) dhe të gjithë informacionin që përfshihet në kërkesën për vizitë.
- c) Në rast se DSIK -ja nuk merr njoftim tjetër, të ndryshëm nga njoftimi i parë i autoritetit kompetent të sigurisë së vendit pritës, të paktën një ditë punë në avancë nga fillimi i datës së vizitës së emergjencës, atëherë vizita mund të kryhet.
- d) Kërkesa për vizitën e emergjencës mund të refuzohet nga DSIK-ja ose nga autoriteti kompetent i sigurisë i vendit, që do të vizitohet.

Dispozita të veçanta

Neni 92

DSIK-ja dhe autoriteti kompetent i sigurisë i vendit, që do të vizitohet, kur bien dakord, se procedurat e përgjithshme nuk janë të plota, kanë të drejtë të vendosin procedura të tjera shtesë tek ISP -ja, sipas kërkesave specifike të dy vendeve.



Neni 93

Detajet për vizitat që përfshijnë aksesin tek informacioni i klasifikuar “SEKRET” dhe “KONFIDENCIAL”, mund të përcaktohen edhe drejtpërdrejt ndërmjet OSI të palëve, nëse kjo është e autorizuar më parë nga DSIK -ja dhe autoriteti kompetent i sigurisë së vendit, që do të vizitohet.

VIII. STANDARDET E SIGURISË PËR PERSONELIN ME KONTRATË TË PËRKOHSHME

Neni 94

Një punonjës i certifikuar përshtatshmërisht i një operatori ekonomik të pakontraktuar, lejohet të punojë me kontratë të përkohshme, për një afat të caktuar, me një kontraktor të një shteti tjetër anëtar të NATO-s, ose të një shteti më të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshjen për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar.

Autoritetet kompetente të sigurisë konfirmojnë paraprakisht nevojën për një punonjës të tillë dhe vlefshmërinë e certifikatës së sigurisë.

Në këto raste, punonjësi duhet të respektojë të gjitha masat dhe standardet e përcaktuara për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

IX. STANDARDET E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “I KUFIZUAR”

Neni 95

Në kushtet e një projekti, programi, kontrate/nëkontrate të klasifikuar në nivelin “I KUFIZUAR”, zbatohen masat dhe standardet e sigurisë të përcaktuara në shtojcën e Manualit të Sigurisë, konceptuar e miratuar nga DSIK -ja.

Për realizimin e një projekti, programi, kontrate/nëkontrate të klasifikuar në nivelin “I KUFIZUAR”, nuk kërkohet pajisja me CSI e operatorit ekonomik/kontraktorit/nëkontraktorit, si dhe pajisja me certifikatë sigurie e personave, që do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar në këtë nivel sigurie.

Në kushtet e një projekti, programi, kontrate/nëkontrate të klasifikuar ndërkombëtare në nivelin “I KUFIZUAR”, përjashtimet e mësipërme nuk mund të aplikohen, kur kjo kërkohet nga legjislacioni i një vendi tjetër, ose autoriteti kompetent i sigurisë.

X. MENAXHIMI I RISKUT TË SIGURISË

Neni 96

Palët në një projekt, program kontratë/nëkontratë të klasifikuar, marrin masa për të menaxhuar riskun e sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ISP-në për të gjitha kategoritë e informacioneve të klasifikuara, në kuadrin e projektit, programit, kontratës/nëkontratës së klasifikuar.

Neni 97

OSI i kontraktorit, në bashkëpunim me PPAK -në, propozojnë planin e vlerësimit dhe të menaxhimit të riskut të sigurisë, i cili miratohet nga drejtuesit e palëve në kontratë.

Plani i vlerësimit dhe menaxhimit të riskut të sigurisë përshkruan kundërmasat e sigurisë, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur informacionin e klasifikuar, shërbimet apo pajisjet mbështetëse në kushtet e kontratës së klasifikuar, bazuar në vlerësimin real të kërcënimeve dhe dobësive të sigurisë.

XI. INSPEKTIMI I MASAVE TË SIGURISË INDUSTRIALE

Neni 98

PPAK dhe OSI janë individët kompetentë për inspektime periodike të brendshme. Ato kryejnë, jo më pak se dy herë në vit, inspektime rreth aplikimit të standardeve të sigurisë, në kushtet e kontratës së klasifikuar dhe në mënyrë të veçantë në ambientet, në të cilat ruhet dhe administrohet informacioni i klasifikuar.

Pas inspektimeve të kryera, ata u adresojnë titullarëve të tyre raportin e inspektimit, me propozimet për marrjen e masave korrigjuese. Në çdo rast, një kopje e raportit të inspektimit i adresohet edhe DSIK-së.

Neni 99

DSIK kryen inspektime periodike për aplikimin e standardeve të sigurisë, në kushtet e kontratës së klasifikuar, tek autoriteti kontraktor dhe kontraktori/nëkontraktori.

Inspektimet nga DSIK-ja realizohen të paktën një herë në dy vjet, ose kur afatet e kontratës janë më të shkurtra, jo më pak se një herë, për një kontratë të klasifikuar.



Neni 100

Inspektimet e DSIK-së tek autoriteti kontraktor përqendrohen tek aplikimi i standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, për të gjitha disiplinat e sigurimit të informacionit të klasifikuar; para, gjatë dhe pas përfundimit të kontratës së klasifikuar.

Inspektimet e DSIK-së tek kontraktori përfshijnë nivelin e zbatimit të detyrimeve të përgjithshme të sigurisë, sipas kontratës dhe detyrimeve, që burojnë nga implementimi i masave të parashikuara tek ISP.

Neni 101

Raporti i inspektimit i DSIK-së, së bashku me rekomandimet e masave dhe afatin e fundit për korrigjimin e parregullsive e shkeljeve të konstatuara, i adresohen titullarit të autoritetit kontraktor.

Autoriteti kontraktor, brenda 20 ditëve kalendarike nga dita e marrjes së raportit të inspektimit të DSIK, ka detyrimin që të njohë drejtuesin e kontraktorit me mangësitë, rekomandimet dhe afatet e përcaktuara për korrigjimin e shkeljeve të sigurisë në kushtet e kontratës së klasifikuar.

Autoriteti kontraktor, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose kontraktori nëpërmjet autoritetit kontraktor, kanë të drejtën që të paraqesin kërkesë me shkrim tek DSIK-ja, për rishikimin e elementëve të paraqitur në raportin e inspektimit.

DSIK-ja duhet të kthejë përgjigje me shkrim, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për rishikimin e elementëve të raportit të inspektimit.

Mospërbushja e masave të rekomanduara dhe afateve të lëna për korrigjimin e parregullsive dhe të shkeljeve të konstatuara nga raporti i inspektimit të DSIK, përbën shkak të mjaftueshëm për pezullimin e përkohshëm, ose heqjen e CSI-së.

XII. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 102

Ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë / kontraktorët / nënkontraktorët e interesuar, të marrin masa për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Ngarkohet DSIK -ja për kontrollin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 44 lekë